

Paaftësi

Udhëzues mbi aftësitë e kufizuara për muzetë

An updated version of this
Toolkit will soon be available

Përgatitur nga Michèle Taylor
me kontribute të kolegëve
nga Ballkani Perëndimor



Udhëzues mbi aftësitë e kufizuara për muzetë

Përgatitur nga Michèle Taylor
me kontribute të kolegëve
nga Ballkani Perëndimor

për

Trashëgiminë Kulturore pa Kufij
Financuar nga
Fondacioni Stavros Niarchos

Hyrje

Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) është një organizatë jo-qeveritare e pavarur suedeze e cila i është përkushtuar shpëtimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme që ndikohet nga konfliktet, neglizhenca apo katastrofat njerëzore dhe natyrore. Ne e konsiderojmë punën tonë si një kontribut me rëndësi jetike për ndërtimin e demokracisë dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut. CHWB është neutrale përsa u përket palëve në konflikt, por jo për të drejtat e gjithë popujve mbi trashëgiminë kulturore – tani dhe në të ardhmen.

CHWB punon me trashëgiminë kulturore si një forcë aktive për pajtimin, ndërtimin e paqes dhe zhvillimin social e ekonomik duke krijuar kapacitete, ndërgjegjësim dhe mundësi në ruajtjen dhe shpëtimit e trashëgimisë kulturore në shoqëri të prekura nga konflikti, neglizhenca apo katastrofat njerëzore dhe natyrore.

CHWB është e përkushtuar ndaj barazisë, mos-diskriminimit, pjesëmarrjes, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Ky udhëzues synon të mbështesë punën e vazhdueshme për t'i bërë muzetë në Ballkanin Perëndimor më të aksesueshëm dhe mikpritës ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara. Shumë nga ky informacion është përfshirë në projekte dhe seminare të mbajtura në Rrjetin Rajonal të Muzeve të Ballkanit Perëndimor, të mbështetur bujarisht nga Fondacioni Stavros Niarchos. Udhëzuesi është përgatitur nga Michèle Taylor, drejtoreshë e projektit. Ka gjithashtu kontribute nga kolegët në Ballkanin Perëndimor, individë të cilët janë pjesë e Grupit të ri të Aksesit në Ballkanin Perëndimor.

Ky udhëzues është hartuar për t'u përdorur nga secili që dëshiron të zhvillojë praktika përfshirëse. Ju lutemi, përdoreni dhe na vini në dijeni nëse keni gjë që dëshironi ta shtoni!

Për më shumë informacion mbi punën e CHWB, lutemi shihni www.chwb.org

y punim është licencuar nën Creative Commons Attribution-ShareAlike 3.0 Unported License. Për të parë një kopje të licencës, vizitoni <http://creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0/> ose dërgoni një letër në adresën Creative Commons, 444 Castro Street, Suite 900, Mountain View, California, 94041, USA.



10 gjëra që mund të bëni të cilat nuk do t'ju kushtojnë shumë

1. Të bëni publike një adresë emaili dhe një numër telefoni celular ku mund t'ju kontaktojnë (0 €)
2. T'i jepni stafit të radhës së parë një stilolaps dhe një copë letër (1 €)
3. Të zëvendësoni tabelat e vjetra ose të vështira për t'u lexuar me tabela të reja të bëra me kompjuter dhe të plastifikuara. Sigurohuni që materiali i plastifikimit nuk e pasqyron shumë dritën ose përndryshe do të jetë e vështirë të lexohet nga disa njerëz. (0, 50 € për tabelë plus kohën e stafit).
4. Kjo gjë është e dobishme deri sa të mund t'i zëvendësoni tabelat me të tjera më të përherëshme
5. Në Mbretërinë e Bashkuar, IKMV-ja (Instituti Kombëtar Mbretëror për të Verbrit) ka udhëzime në faqen e internetit për t'u siguruar që printimi që bëni është i qartë. Mund t'i hidhni një sy në http://www.rnib.org.uk/professionals/accessibleinformation/text/Pages/clear_print.aspx
6. Siguroni kallama pijesh sa herë që shitni apo shërbeni pije (1 € / muaj).
7. Sigurohuni që buza e përparme e të gjitha shkallëve të jashtme bën kontrast me pjesën kryesore të tyre, dhe që e gjithë sipërfaqja e sheshtë në krye dhe në fund të çdo shkalle ka kontrast të dukshëm që i paralajmëron njerëzit për praninë e tyre (25 €).
8. Lëvizini mobilet që të siguroni rrugica të qarta dhe të gjera rreth muzeut tuaj (0 €).
9. Siguroni një tas me ujë për qentë guidë ose qentë shoqërues të personave që nuk dëgjojnë (3 €).
10. Prodhoni një fletëpalosje vizitori me informacion mbi aksesin, përfshi pengesat (0 €).
11. Me anë të kompjuterit prodhoni versione me shkronja të mëdha dhe të qarta të shënimeve të programit, etiketave apo informacioneve të tjera (€ kostoja e letrës dhe e bojës plus koha e stafit)
12. Kërkojuni vizitorëve tuaj që nuk dëgjojnë dhe kanë aftësi të kufizuara që t'ju japin komente (0 €).



Sigurohuni që të ruani hapësira parkimi për njerëzit me aftësi të kufizuara

Hyrja e të verbërve dhe njerëzve me shikim të kufizuar në muze dhe në vende të trashëgimisë

Pengesat me të cilat përballen të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar

Njerëzit e verbër ose me shikim të kufizuar mund të përballen me shumë pengesa kur vizitojnë muze ose vende të trashëgimisë. Në disa vende nuk ka informacion për vizitorët, ndërtesat janë të vështira për të hyrë ose për të lëvizur në to dhe teksti i tabelave është me shkronja të vogla. Ndonjëherë stafi nuk është i sigurt sa duhet për t'u folur të verbërve apo njerëzve me shikim të kufizuar dhe nuk di se si të ofrojë ndihmë. Tabelat interaktive shpesh bazohen aftësi shikimi të mira dhe mund të mos ketë mundësi për të prekur objekte apo për të marrë informacion duke dëgjuar.

Heqja e pengesave

Muzeu mund ta përmirësojë hyrjen e të verbërve dhe të njerëzve me shikim të kufizuar në shumë mënyra, përfshi:

1. guida audio që janë të aksesueshme nga njerëzit e verbër dhe ata me shikim të kufizuar;
2. vizita me guidë në të cilën shpjegohen ndërtesa, koleksionet dhe përmbajtja;
3. imazhe që mund të preken të cilat paraqesin veprat e artit, objektet, ndërtesat dhe planet e tyre, etj.;
4. prekja e objekteve të vërtetë gjatë vizitave apo seancave me prekje ose duke ofruar modele të cilat mund të preken;
5. sigurohuni që i gjithë informacioni i printuar në vendndodhje ofrohet në një sërë formatesh (për shembull me shkronja të mëdha, në CD, në Braille);
6. t'i lejoni njerëzit t'u afrohen objekteve sa më shumë të jetë e mundur pa rrezikuar dëmtimin e objektit;
7. sigurohuni që të gjitha etiketat dhe interpretimet janë me shkronja të qarta;
8. prodhoni shënime mbi ekspozimet dhe informacion mbi objektet e koleksionet në një letër të cilët vizitorët mund ta mbajnë me vete;
9. prodhoni letra zmadhuese.



Edhe nëse interpretimi juaj do të thotë se teksti është i shkruar me dore, ju përsëri mundeni ta bëni atë të qartë dhe të lexueshëm për shumë njerëz

Përshkrimi audio

Përshkrimi audio është shpjegimi me zë i cili mund të përmirësojë hyrjen në muze dhe vende trashëgimie. Nuk është thjesht një guidë audio e cila mund t'i ofrohet çdo vizitori. Përshkrimi audio bën një përshkrim shumë të detajuar të objekteve dhe të pikturave në mënyrë që të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar të mund t'i kuptojnë ato më mirë. Prodhimi i një përshkrimi të tillë audio kërkon aftësi specifike dhe duhet bërë nga dikush me përvojë. Atyre me siguri do t'ju duhet ndihmë nga stafi i muzeut për të shkruar tekstin në mënyrë që të përfshihet i gjithë informacioni i rëndësishëm.

Përshkrimin audio mund ta bëjë gjithashtu edhe një person gjatë një aktiviteti. Ai mund të jepet me kufje ose mund të flitet përpara të gjithëve, nëse objektivi i aktivitetit janë të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar.

Prodhimi i diagrameve dhe paraqitjeve me prekje

Disa njerëzve të verbër ose me shikim të kufizuar u pëlqen të përdorin harta dhe diagrame me prekje dhe disa të tjerëve u pëlqen edhe të kenë paraqitje me prekje të pikturave dhe figurave të tjera.

Hartat dhe diagramet e thjeshta mund të bëhen me prekje duke përdorur fill, ngjitës dhe materiale të tjera që mund të preken në mënyrë inteligjente.

Në Mbretërinë e Bashkuar, faqja e internetit të Qendrës Kombëtare për Diagramet me Prekje jep një përmbledhje të mirë të mënyrave të ndryshme si mund të prodhohen imazhet me prekje.

Aksesi i koleksioneve në rrjet

Zhvillimi i internetit do të thotë se tashmë shumë të verbër dhe njerëz me shikim të kufizuar kanë mundësinë të shijojnë shumë informacion dhe shërbime. Sigurohuni që faqet janë vizualisht të qarta ndërsa skiconi dhe krijoni faqen tuaj të internetit.

Në Mbretërinë e Bashkuar, IKMV-ja (Instituti Kombëtar Mbretëror për të Verbrit) ka udhëzime se si ta bëni faqen tuaj të internetit të aksesueshme nga të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar.

Hidhini një sy në

http://www.rnib.org.uk/professionals/webaccessibility/designbuild/Pages/design_build.aspx

Shihni në rrjet gjithashtu edhe www.accessify.com/tools-and-wizards/accessibility-tools/ pasi ka disa mjete që ju ndihmojnë të krijoni faqe dhe dokumente interneti të aksesueshme. Këtu ka madje edhe një instrument të cilin e aktivizoni për t'ju treguar problemet e aksesit që mund të ketë faqja juaj e internetit.

Muze për të gjithë

Tatjana Mijatović, Muzeu Kombëtar i Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë

Bashkëpunimi i CHwB (Cultural Heritage without Borders - Trashëgimia Kulturore pa Kufij) dhe Fondacionit Stavros Niarchos me Muzen Kombëtar të Bosnjës dhe Hercegovinës ndihmoi në hedhjen e hapave të parë drejt aksesueshmërisë në njërin prej institucioneve më të vjetër të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Ne kemi punuar në dy projekte:

- “Guidë audio për njerëz të verbër dhe me shikim të kufizuar” dhe
- “Muze në valixhe”

“Guidë audio për njerëz të verbër dhe me shikim të kufizuar”

Hapi i parë ishte kërkimi i zgjidhjeve teknike që ofrohen për njerëzit e verbër dhe me shikim të kufizuar, duke kërkuar në internet dhe duke analizuar projekte për aksesin në muze të tjerë. Pasi u mbledh një sasi e madhe informacioni, një konkluzion ishte i pashmangshëm: “Nuk kam asnjë kriter për të përzgjedhur zgjidhjen më të mirë!” Kështu që mësova për nevojat e njerëzve të verbër dhe me shikim të kufizuar nga ekspertë që punojnë në këtë fushë në bibliotekë dhe në një shkollë. Zbulova se:

- një nga faktet më të rëndësishëm që mësova është se Braille mund të lexohet vetëm nga njerëzit që kanë lindur të verbër ose e kanë humbur shikimin në moshë shumë të re. Ky pati një ndikim thelbësor në zgjidhjen më të mirë.
- është e rëndësishme që informacioni të mbledhet nga institucione që mbështesin të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar në nivel profesional
- është e rëndësishme të krahasohen burimet e ndryshme
- është thelbësore të përfshihen të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar në çdo fazë të projektit pasi janë burimi më i mirë i informacionit dhe kritikët më të mirë të procesit.

Objektivi i këtij projekti është t’u mundësojë njerëzve të verbër dhe me shikim të kufizuar të vizitojnë koleksionet ekzistuese të muzeut në mënyrë të pavarur, dhe gjithashtu të kuptojnë atë që është ekspozuar.

Për ta bërë vërtet muzeun tonë **muze për të gjithë**, ishte e rëndësishme të përfshiheshin gjithë grupmoshat dhe grupet e të verbërve e vizitorëve me shikim të kufizuar. Prandaj mund të themi se kemi lloje ekspozitash "të përgjithshme" ose ""intro".

Kuptimi i nevojave për akses më ndërgjegjësori sa sa e madhe duhet të ishte ndërhyrja në muze: muzeu nuk ishte bërë “për t’u prekur”! Në të njëjtën kohë u ndërgjegjësova se nuk ishte e mundur të bëhej e gjitha. Duhet bërë plane, dhe ky projekt duhet të jetë *një bazë e mirë për përmirësime të mëtejshme* të cilat besoj se do të jenë më të lehta për t’u bërë se sa hapi i parë.

Teknologjia

Më në fund u përzgjedh një lexues barkodi "I.D. Mate" si zgjidhja më e mirë dhe më e thjeshtë dhe ç'është më e rëndësishmja, një zgjidhje që funksionon për të gjithë.

Ai është një skaner barkodi me zë portativ "të-gjitha-në-një" i cili i ndihmon njerëzit të identifikojnë objektet nëpërmjet barkodit ose Kodit Universal të Produktit (KUP). Ai i lejon përdoruesit të aksesojnë një databazë në bord të përshkrimit të produkteve duke përdorur teknologjinë e kthimit të tekstit në zë dhe regjistrimit dixhital të zërit, së bashku me një grup të përshtatur mesazhesh të regjistruara.

Meqenëse gjithë informacioni ruhet në një kartë memorieje të vogël, kjo pajisje e vogël mund të përdoret në situata të ndryshme, guida audio mund të jetë në gjuhë të ndryshme apo të përdoret për qëllime të ndryshme. Gjithçka që duhet bërë është të ndryshohet karta e memories.

Tani kemi tre lexues barkodi, sepse kemi tre departamente në muze dhe në rast se kemi vizita të mëdha, mund t'i ndajmë vizitorët në tre grupe për t'ua bërë përvojën më të mirë.

Një problem i mundshëm mund të jetë që, në fund të fundit, ajo është pajisje, askush nuk dëshiron të jetë përgjegjës për të apo dëshiron të mësojë "gjëra të reja të ndërlikuara" (pavarësisht se kjo nuk është e ndërlikuar). Përgjigja jonë ndaj këtij problemi është të etiketojmë barkodin tek lexuesi me udhëzime të detajuara për këtë pajisje.

Realizimi i muzeve të parë me ekspozita me prekje për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar

Së bashku me kuratorët dhe kujdestarin bëme një përzgjedhje të objekteve të muzeut të cilat do të formonin koleksionin tonë me prekje.

- Në departamentin arkeologjik përdorëm objektet e ekspozuar nga koleksionet ekzistuese.
- Departamenti etnologjik përdori objektet e blerë origjinale dhe për këtë qëllim u blenë e u prodhuan disa objekte të rinj.
- Problemi më i madh ishte departamenti i historisë së natyrës, pasi të gjitha ekspozimet janë vendosur pas xhamit, kështu i bëme të gjitha objektet nga e para në modele që mund të preken dhe i ekspozuam ato pranë origjinalit.

Një pjesë e njohurisë sime duhej kaluar tek kuratorët, sepse atyre u duhej të bënin një përshkrim mbi objektet që mund të preken për t'u siguruar që të gjithë kanë mundësinë ta kuptojnë plotësisht atë që është ekspozuar. Nëse u tregoni apo i informoni të gjithë kolegët tuaj (nga kuratorët deri tek artizanët) mbi punën tuaj, do të jetë më e thjeshtë të përmbushni qëllimet tuaja. Ndoshta, si në rastin tim, një letër zyrtare nga drejtori i muzeut mund të jetë e dobishme pasi do t'i bëjë njerëzit të kuptojnë rëndësinë e punës suaj.

Një nga gjërat më të rëndësishme që do t'i lidhë të gjitha pjesët në një të tërë është prodhimi i hartave me prekje dhe i një guide mbi aksesueshmërinë. Për vizitorin është informacion thelbësor:

- prodhimi i një harte me prekje të muzeut me pozicionet e ekspozitave me prekje dhe
- prodhimi i një guide aksesueshmërie që mund të lexohet në faqen tonë të internetit.

Unë kam ndjekur trajnimin për imazhet me prekje në Institutin Mbretëror Kombëtar për të Verbrit në Birmingham, MB, të ofruar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Kjo kishte shumë rëndësi në ndihmën për të realizuar këtë projekt.

Vetëm pas këtij trajnimi fillova të kuptoja se si është një imazh i mirë me prekje dhe mund t'i dalloja menjëherë të gjitha gabimet që kisha bërë në hartën time mjaft të saktë teknikisht!

CHWB ofroi pajisje për realizimin e imazheve me prekje dhe katër prej kolegëve to mi dhe unë kemi dhënë trajnim mbi mbi imazhet me prekje për profesionistë nga 11 muze të ndryshëm nga Rrjeti i Muzeve Ballkanikë.

Një grup i synuar - Një promovion

Promocioni i të dy projekteve u krye me anë të medias (radios, revistave dhe portaleve në internet), me anë të prezantimit të projektit në "Qendrën për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar" dhe duke informuar shkollat rreth seminareve edukativë. Një promovion i madh u mbajt në Muzeun Kombëtar të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet që seminarët e mbajtur nëpër shkolla edukojnë vizitorë të pavarur të ardhshëm muzesh.

Këshilla bazë për ta bërë të aksesueshme faqen tuaj të internetit

Sigurohuni që kushdo që ndërton faqen tuaj të internetit i kupton problemet e aksesit dhe që faqja po ndërtohet duke pasur ndër mend aksesin që në fillim. Kjo do të jetë më efikase se sa t'i ktheheni më vonë për të bërë korrigjime dhe ndryshime.

Mbani mend

1. nëse keni një buton të cilin njerëzit e klikojnë për të shkuar në një faqe akses, siguroheni që është vendosur majtas sipër në kryefaqe, përndryshe ata mund të kenë vështirësi për ta gjetur.
2. ofroni një version të faqes që ka vetëm tekst dhe jo figura;
3. përdorni tekstin me butonin "alt" për të ofruar përshkrime shprehëse të imazheve/grafikave;
4. ofroni dokumente që mund të shkarkohen në formate RTF, PDF dhe Word;
5. sigurohuni që informacioni është paraqitur qartë dhe që lidhjet identifikohen lehtë;
6. ofroni tekstin e shkruar ose transkriptimin e çdo materiali audio apo audio-vizual;
7. sigurohuni që është e lehtë të navigoni nëpër faqen e internetit dhe midis faqeve, dhe sidomos që kthimi në kryefaqe është gjithmonë i thjeshtë;
8. ofroni një hartë të faqes së internetit;
9. mbani kontrast të lartë vizual midis tekstit dhe sfondit;
10. mos përdorni tekst apo lidhje të vogla që kanë nevojë për lëvizje shumë të sakta me mouse;
11. ndiqni udhëzimet e qarta të përgjithshme për printim (për shembull, mos vendosni tekst mbi imazh);
12. mos përdorni tekst që ndriçon, pulson apo grafika e butona që ndizen.


Kontrulli i faqes suaj të internetit

Duhet t'i referoheni udhëzimeve të Iniciativës për Akses në Rrjet për informacion të aksesueshëm. Këtu ka një përmbledhje të shkurtër "për një shikim":

<http://www.w3.org/WAI/WCAG20/glance/>

Të gjitha faqet e internetit duhet të përmbushin të paktën standardet minimale.





Hapja e faqes ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara është një hap
i rëndësishëm drejt dhënies së aksesit në muzeun tuaj



Porositja dhe prodhimi i modeleve

Ivan Krucican, Muzeu Kombëtar i Serbisë, Beograd

Historiku

Gjatë vitit 2009, na u dha një donacion nga CHwB për të prodhuar gjashtë modele me prekje të monumenteve mesjetarë, që do të përdreshin në Galerinë e Afreskeve të Muzeut Kombëtar të Serbisë në Beograd. Kjo do të ishte një pjesë e re e ofertës sonë përfshirëse. Këta gjashtë modele ishin pjesë e planit për të prodhuar rreth 20 modele monumentesh nga periudha të ndryshme, të cilat do të ishin shumë të vlefshme në punën tonë përfshirëse edukuese me grupe shkollash, shkollash të veçanta dhe të rriturish.

Çfarë bëmë

Për të realizuar këtë, ne morëm në punë një krijues modelesh të ri, i cili në atë kohë ishte ende student i vitit të fundit në akademinë e arteve në Beograd, por që kishte fituar disa çmime., përfshi çmimet për dy modele të prodhuar për Muzeun Kombëtar në Beograd në vitin 2008.

Çmimi për të cilin u ra dakord dhe që u vendos në kontratë ishte shumë i ulët, por ai pranoi ta bënte si një farë favori për muzeun tonë. Puna ishte shumë delikate dhe ai u vonua në dorëzimin e modeleve. Me një konfirmim nga CHwB, atij iu dhanë edhe 4 muaj kohë, por edhe pas kësaj periudhe nuk e përfundoi. Në mars 2010 kishin përfunduar plotësisht vetëm dy modele dhe kishte nisur një tjetër. Na u desh që të zgjidhnim ose të ndalonim projektin dhe të kthenim paratë, ose të kërkonim një shtyrje tjetër. CHwB miratoi edhe një shtyrje dhe ne vazhduam me katër modelet e mbetur.

Më në fund, katër modelet me prekje përfunduan dhe fondi mbuloi koston e materialeve, tarifën e krijuesit të modeleve dhe të këshilltarit tonë nga Shoqata e të Verbërve të Serbisë, por patëm probleme për shkak të vonesës.

Çfarë mësuam

Nuk shkoi aq mirë sa shpresonim apo prisnim, por ekspozita që organizuam u prit mirë nga vizitorët tanë të verbër dhe me shikim të kufizuar. Ajo u ndoq nga katalogu në Braille dhe ky bashkëpunim u hapi rrugën ideve dhe projekteve të reja për të ardhmen.

Problemi me të cilin u përballëm ishte se më atë pagesë nuk mund t'i kërkonim krijuesit të modeleve të punonte më shpejt, por më në fund morëm katër modele me çmimin e njërit apo edhe më pak. Cilësia e modeleve është e shkëlqyer dhe ata do të përdoren për të dyja ekspozitat dhe programet edukative gjatë disa dekadave të ardhshme.

Për shkak të burimeve të kufizuara na u desh të improvizonim shumë, por nxorëm një mësim. Nga gabimet tona mësuam si të planifikojmë më mirë dhe ose të bëjmë plane afatshkurtër (si për shembull çdo herë nga një model) ose të krijojmë

bashkëpunim më të gjerë me Ministrinë tonë dhe institucione e organizata të ndryshme për të punuar mbi diçka që nuk kufizohet nga afate të rrepta.

Instalimi i një ekрани me prekje

Danica Ivanëviæ, Muzeu i Qytetit të Novi Sad-it, Serbi

Historiku

Muzeu ynë gjendet në fortesën mbi kodër dhe ka 249 shkallë! Nuk kemi tualete të aksesueshme, apo lehtësi të tjera të cilat ua bëjnë më të thjeshtë vizitën në muze njerëzve me aftësi të kufizuara. Për shembull, nuk ka legjenda të përshtatshme për njerëzit me aftësi të kufizuara në ekspozita dhe as infrastrukturë të mirë. Nëse njerëzit me aftësi të kufizuara dëshirojnë të vijnë në muze, duhet të mundohen shumë, dhe pa mjete transporti, për ta është e pamundur.

Njerëzit me aftësi të kufizuara e kanë të pamundur t'i tejkalojnë këto pengesa; për ta është një mision i pamundur!

Çfarë bëme

Vitin e kaluar organizuam një aktivitet për të promovuar ekranin tonë me prekje. Në këtë aktivitet morën pjesë në mënyrë aktive organizata të njerëzve me aftësi të kufizuara. Sugjerimet e tyre na ndihmuan shumë: mësuam se sa lart dhe ku saktësisht ta vendosnim ekranin dhe si ta bënim atë të aksesueshëm.

Na ndihmuan shumë njerëz nga Rotary Club, sepse ne siguroam një pjesë të fondit për realizimin e këtij projekti.

Ekranin me prekje përfshin një paraqitje audio-vizuale si të ekspozitës ashtu edhe të galerive ushtarake të nëndheshme, të cilat janë krejtësisht të pa-aksesueshme nga individët me lëvizje të kufizuara.

Çfarë mësuam

Ekranin me prekje është një gjë shumë e mirë dhe e dobishme dhe njerëzit me aftësi të kufizuara janë të shumë të lumtur që marrin pjesë në aktivitetet kulturore të qytetit. Puna me njerëzit me aftësi të kufizuara dhe dëgjimi i këshillave të tyre ishin shumë të dobishëm.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë për ta bërë jetën tonë kulturore më të aksesueshme.

Ne kemi një platformë të pjerrët, ekran me prekje, dy guida në Braille dhe vullnetin për të mirëpritur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për të punuar me ta sa herë të jetë e mundur.

Muzeu i shqisave

Simonida Miljkovikj, Muzeu Kombëtar i Maqedonisë

Projekti *Muzeu i Shqisave* u mundësua nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij dhe Fondacioni Stavros Niarchos.

Ka vite tashmë që Muzeu NI i Maqedonisë, Departamenti për Menaxhimin dhe Edukimin e Muzeut, ofron programe për njerëzit me aftësi të kufizuara, si pjesë e programit arsimor. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar ka rezultuar në shumë projekte.

Kemi objekte në muze që janë shumë të kërkuar nga vizitorët, por të cilët nuk mund të preken e janë vendosur në vitrina prej xhami për t'u ruajtur.

Njëra prej tyre është ena e ujit, Hydria. Ai është një objekt i vjetër, interesant dhe për disa njerëz, i pazakontë për shkak të formës së tij, por sidomos për shkak të historisë së përshkruar nga elementët e pikturuar.

Edukatorët në muze u frymëzuan që të mendonin më gjerësisht rreth “muzeut të shqisave”: qeniet njerëzore e ndjejnë botën që i rrethon duke përdorur shqisat bazë: shikimin, dëgjimin, prekjen, shijen dhe nuhatjen.

Kështu që, planifikuam dhe realizuam Projektin "Muzeu i Shqisave" me temë:

Grupi i synuar

Objekti i projektit tonë ishin studentët e Shkollës Shtetërore të Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve me Shikim të Kufizuar, “Dimitar Vlahov” në Shkup, së bashku me familjet dhe mësuesit e tyre.

Grupet u ndanë në grupe më të vegjël me nga pesë studentë dhe ne programuam vizitat në Muze.

Objektivat e projektit

Ne dëshironim që

- t'ua paraqisnim studentëve Muzeun si një vend për të pasuruar dijen e tyre dhe për t'u shoqëruar me të tjerë;
- t'u mësonim studentëve të verbër e me shikim të kufizuar trashëgiminë tonë të pasur kulturore;
- të përcaktonim metodologjinë për edukim të suksesshëm muzeor dhe të organizonim një formë të re paraqitjeje;
- të ofronim mundësi për të nxitur pjesëmarrje dhe përfshirje të barabartë në shoqëri për njerëzit e verbër e me shikim të kufizuar (gjithashtu edhe njerëz me aftësi të tjera të kufizuara);
- të realizonim dhe të promovonim të drejtat themelore civile dhe humane të njerëzve me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet

Aktivitetet e projektit ndahen në tri faza.

Maj deri në tetor 2011, përgatitja

Krijimi i një grupi ekspertësh nga Muzeu dhe përcaktimi i kuadrit të përgjithshëm mbi të cilin do të realizohet projekti

Vendosja e kontaktit me grupin menaxhues dhe grupin e ekspertëve nga Shkolla. Vizita e tyre në muze dhe vizita e edukatorëve të muzeut në shkollë.

Përgatitja e tekstit profesional, të përshtatur për grupin e synuar.

Përcaktimi i listës së materiale që nevojiten për të realizuar programin.

Prodhimi i vizatimeve me relief në makinerinë me fryrje.

Shtypja e tekstit në alfabetin Braille dhe tekst me format më të madh

Instalimi në një kompjuter i *programit të të folurit*

Regjistrimi në një CD i historisë së Hidrës dhe të mitit të perëndisë Dionis.

Dhjetor, 2011 (Muaji i njerëzve me aftësi të kufizuara), vizita dhe aktivitete me studentë.

Çdo student shoqërohej nga një edukator ose profesor.

Pasi u shpjegohet plani i ambienteve të mësimin, studentëve iu jepet mundësia të hapin sirtarët dhe të prekin sendet brenda tyre, t'i nuhasin, t'i shohin, t'i dëgjojnë dhe t'i shijojnë, si edhe të gjejnë dhe të mbledhin historinë e objektit të muzeut. Pastaj atyre u jepet mundësia të mësojnë historinë e mitit të perëndisë Dionis duke prekur vizatimet me relief. Ata kanë mundësi t'i dëgjojnë të gjitha këto me anë të kompjuterit.

Studentët u nxitën të mendonin në mënyrë krijuese dhe logjike dhe të përfshiheshin në mënyrë aktive në seminarin e muzeut, për të transferuar frymëzimin e tyre në një vizatim i cili përpunohet në një makineri "fryrëse". Rezultatet nga seminarin e muzeut, të përfaqësuara nga vizatimet me relief, do të paraqiten në një ekspozitë në Muzeun e Maqedonisë dhe në shkollë.

Vizitat përfunduar me pije freskuese dhe me një dhuratë për çdo student: një dosje me tekstin të shkruar me alfabet Braille dhe një CD ku është regjistruar historia e hidrës dhe miti i perëndisë Dionis.

Dhjetor 2011, rishikim

Ne dëshironim që

- të arrinim bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet për individët me aftësi të kufizuara;
- të arrinim integrimin social të njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqërinë moderne;

- të ndërgjegjësonim njerëzit me aftësi të kufizuara mbi promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore;
- të përcaktonim metodologjinë për realizimin e edukimit muzeor, duke përdorur mjete metodash të ndryshme.

Qëndrueshmëria e projektit

Përmbajtja e përgatitur dhe ekspozita e muzeut të shqisave do të zbatohet në edukimin e ardhshëm në muzeun e Maqedonisë, përfshi për njerëz me aftësi të tjera të kufizuara nëpërmjet Shoqatave të tyre, anëtarët e Klubit të Muzeut të Fëmijëve dhe vizitorëve në përgjithësi.

Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen më të thellë për ndihmën financiare dhe materiale të marrë prej organizatës suedeze Trashëgimi Kulturor pa Kufij, të mbështetur nga Fondacioni Stavros Niarchos. Duam të falënderojmë në veçanti Dr. Diana Walters, Koordinatorë Rajonale e Muzeut, e cila filloi këtë bashkëpunim për projektin e *Muzeut të Shqisave*.

Shkëmbimi i përvojave në punën me profesorët dhe ekspertët u ka dhënë studentëve, por edhe neve, edukatorëve të muzeut, kënaqësi dhe vetëbesim më të madh.



Prodhimi i informacionit të aksesueshëm me shkrim

Ne rekomandojmë që

1. gërmat në një fletëpalosje apo broshurë të jenë të madhësisë 12 ose më shumë
2. gërmat në postera edhe më të mëdha (të madhësisë së paku 18) në mënyrë që të lexohen lehtë në distancë
3. gërmat të jenë të llojit sans serif

Këto janë gërma të llojit sans serif. Janë të thjeshta dhe lexohen më lehtë se

këto, të cilat janë gërma serif, që përbëhen nga vija hutuese shtesë

4. nuk ka tekst të printuar mbi foto apo diagram
5. gërmat janë të zeza ose blu të errëta mbi të bardhë ose të verdhë, ose të bardha apo të verdha mbi të zeze apo blu të errët. Kjo na jep kontrastin më të mirë vizual

kjo është e zezë mbi të bardhë


Kjo është e bardhë mbi të zezë

6. të përdoret një përzierje shkronjash të mëdha dhe të vogla për tekstin, siç shkruani zakonisht, në vend që të përdoren vetëm shkronja të mëdha

Kjo është përzierja e zakonshme. Në të përdoren shkronja të vogla dhe të mëdha, aty ku prisni t'i shihni, ndryshe nga

KJO, E CILA ËSHTË E GJITHA ME SHKRONJA TË MËDHA DHE E VËSHTIRË PËR T'U LEXUAR

7. në tekst nuk përdoren shkronja të pjerrëta, të cilat janë të vështira për t'u lexuar
8. teksti është i gjithi në një kolonë, meqenëse më shumë kolona e bëjnë aksesin më të vështirë
9. teksti është rreshtuar nga e majta, në vend që të ishte për shembull, në qendër apo i rreshtuar nga e djathta.



Kjo pjesë teksti interpretues është shkruar mbi një foto dhe kështu që është pothuajse e pamundur të lexohet

Ky tekst është i rreshtuar nga e majta

Ky është në qendër

Ky është i rreshtuar nga e djathta

10. përdorni një letër e cila nuk ka shkëlqim dhe është të paktën 90 gsm (kjo redukton mundësinë që të shihet teksti nga ana tjetër)
11. materiali ofrohet në letra me ngjyra të ndryshme (disa njerëz preferojnë letër jo të bardhë, si për shembull disa njerëz me disleksi)
12. gjithmonë shmangeni të gjelbrën, rozën dhe të kuqen (përveç rasteve kur këto ngjyra kërkohen në mënyre specifike) sepse ato mund të jenë të vështira për njerëzit daltonikë

Kjo pjesë është shkruar me gërma të mëdha dhe është prodhuar me anë të një pakete kompjuterike të zakonshme.

Duke përdorur të njëjtat parime si më sipër, sigurohuni që madhësia e gërmave tuaja të jetë midis 16 dhe 22 (kjo është madhësi 18).

Mund t'i ndryshoni dokumentet duke e përzgjedhur të gjithin dhe duke rritur madhësinë e gërmave.

Alfabeti Braille

Kjo është një mënyrë të shkruari duke përdorur pika të ngritura mbi një fletë. Prodhohet duke përdorur një makinë të krijuar enkas për të dhe përkthimi i një dokumenti të madh mund të jetë i kushtueshëm.


Kasetë audio ose CD

Mbani mend që ky format mund të jetë i dobishëm për shumë njerëz që preferojnë më shumë të dëgjojnë se sa të lexojnë.

Është e pranueshme që të regjistroni vetë një kopje të vetme të kasetës. Sigurohuni që flisni ngadalë dhe qartë dhe që përshkruani çdo tabelë apo diagramë që gjendet në dokument.

Informacioni elektronik

Shumica e të verbërve kanë softuerë dhe/ose harduerë vetë, gjë që do të thotë se mund të marrin informacion në disk ose CD me e-mail dhe ta përdorin atë në mënyrën më të mirë për ta. Kjo mund të jetë duke përdorur softuerë të cilët u 'lexojnë' informacionin, ose duke përdorur makineri që e



përkthejnë dokumentin në alfabet Braille, ose që thjesht e prodhojnë me gërma të mëdha.

Faqet e aksesueshme të internetit

Njerëz me shumë lloje aftësish të kufizuara, gjithnjë e më tepër i drejtohen internetit për informacion. Një faqe interneti e cila është programuar dhe ndërtuar duke pasur në mend aksesin që në fillim, do të jetë e lehtë për të naviguar dhe për t'u përdorur.

Porositja e një guide audio

Hyrje

Ky është një version i shkurtuar i një dokumenti të prodhuar nga Talking Images, i cili është një projekt i krijuar nga Instituti Kombëtar Mbretëror për të Verbrit, Vocal Eyes (një organizatë që i është përkushtuar mbështetjes së përshkrimit audio me cilësi të lartë), që synon të përmirësojë aksesin në muze dhe galeri për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar.

Nëse jeni të interesuar, mund të mësoni më shumë rreth Talking Images në

rhib.org.uk/professionals/solutionsforbusiness/leisure/museums/galleries/Pages/talking_images.aspx

Mund të mësoni më tepër rreth VocalEyes në www.vocaleyeyes.co.uk/

Për t'u pasur parasysh përpara se të bëhet porosia

Përpara edhe se të filloni të porositni një guidë audio, është e rëndësishme të mendoni mbi disa çështje dhe ndikimin e tyre në vizitorët e verbër dhe ata me shikim të kufizuar.

Përse dëshironi të keni një guidë audio?

Një guidë audio, njerëzve të verbër dhe me shikim të kufizuar, mund t'ju ofrojë më së miri:

- një vizitë të pavarur ku atyre nuk iu duhet të mbështeten tek anëtarët e stafit apo ndihmë tjetër për të parë
- një shërbim i cili nuk ka nevojë të prenotohet paraprakisht dhe ofrohet gjatë gjithë kohës
- një nivel i lartë i vazhdueshëm informacioni rreth objekteve dhe ekspozitave në muzeun tuaj.

Megjithatë, vetëm guida audio nuk i zgjidh të gjitha problemet e aksesit për njerëzit e verbër dhe ata me shikim të kufizuar dhe ju duhet ta shihni thjesht si njërin aspekt të masave tuaja.

A i duhet muzeut tuaj një guidë audio?

Mund të ketë raste kur guida audio nuk është zgjidhja më e mirë për akses në muzeun tuaj. Për shembull, nëse ekspozitat tuaja ndryshojnë shpesh dhe ju e dini se nuk do të jeni në gjendje ta përditësoni guidën rregullisht, ose vendndodhja juaj ka një plan të ndërlikuar (do të ishte më mirë që të përpiqeni e të gjeni mënyra më të thjeshta që njerëzit e verbër e me shikim të kufizuar të orientohen në muze përpara se të merrni në konsideratë një guidë audio).



Programi Preke në Muzeun Britanik u lejon njerëzve të prekin objektet dhe stafi i trajnuar mund t'u japë atyre përshkrim audio

Mund të mendoni të ndërmerrni një veprim tjetër, të tillë si trajnim të stafit për ndërgjegjësim vizual dhe aftësi përshkruese, ose të ofroni vizita për një person përveç ose në vend të guidës së regjistruar.

Kujt i drejtohet guida?

Një guidë e shkruar për njerëzit e verbër dhe me aftësi të kufizuara ka të ngjarë që të ketë më tepër përshkrime të detajuara sesa një guidë e përgjithshme, dhe gjithashtu mund të përmbajë informacion rreth hapësirave fizike në të cilat ndodhen njerëzit kur janë duke i dëgjuar.

Ky informacion i përgjithshëm mund të jetë gjithashtu në një guidë të përgjithshme. Guidat audio mundësojnë "shtresëzimin" e informacionit, në mënyrë që dëgjuesi të zgjedhë të dëgjojë regjistrime shtesë apo jo. Kjo do të thotë që një guidë "përfshirëse" mund të ndihmojë shumë grupe të ndryshëm vizitorësh.

A do t'u kërkonte njerëzve të verbër dhe me shikim të kufizuar të paguajnë për përdorimin e guidës audio?

Edhe nëse vendosni ta bëni guidën audio me pagesë për shumicën e vizitorëve, nuk duhet t'u kërkonte pagesë të verbërve dhe atyre me shikim të kufizuar. Të verbërve dhe njerëzve me shikim të kufizuar shpesh u refuzohet aksesimi në informacion dhe nuk ka mundësi që t'u ofrohet gjithë informacioni në muzeun apo vendndodhjen e trashëgimisë suaj. Një qasje përfshirëse, si dhe alternativa që preferohet, është që guida t'i ofrohet falas kujtdo që thotë se ka aftësi shikimi të kufizuara apo se është i verbër.

Ku do të merret dhe kthehet guida audio?

Ne rekomandojmë që një guidë audio të ruhet dhe të shpërndahet në një vend të arsyeshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm. Të gjithë anëtarët e stafit në vendndodhje duhet të dinë rreth saj, ku ruhet dhe si përdoret. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse guida nuk përdoret shumë shpesh. Gjithashtu, është thelbësore që t'u tregoni vizitorëve për guidën duke përdorur shenja të qarta e të mëdha përreth muzeut.

Si do të lidhet guida audio me shërbime të tjera dhe interpretimin në muze?

Guida audio nuk duhet të jetë e vetme. Ajo duhet të theksojë qartë mundësitë për të prekur objekte në muze dhe duhet të lidhet me lehtësi të tjera të tilla si imazhe me prekje, modele dhe informacion i mëtejshëm apo harta në formate të aksesueshme.

Shumë të verbër dhe njerëz me shikim të kufizuar mund të aksesojnë informacion audio. Si rrjedhim, guida audio është një mundësi e shkëlqyer për t'i njohur vizitorët me shërbime të tjera si dyqani, kafeneja dhe tualetet si dhe ku gjenden ato.

Si do t'ua promovoni atë të verbërve dhe njerëzve me shikim të kufizuar?

Nuk ka kuptim të prodhohet një guide audio nëse askush nuk di gjë për të. Përpara se të prodhoni një guidë audio është e rëndësishme të mendoni se si dhe ku t'u tregoni njerëzve për të. Kjo do t'ju marrë kohë dhe burime. Sa më shumë kontakte të keni me njerëzit e verbër dhe me shikim të kufizuar vendas, aq më shumë mund t'i përdorni për t'u treguar njerëzve çfarë ofron muzeu juaj. Guidën duhet të promovoni gjithashtu në të gjitha materialet tuaja reklamuese të përgjithshme.



Çështje që duhet të merren në konsideratë nëse porositni një guidë audio

Këshillim me të verbrit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara

Duhet t'i kërkonti prodhuesit të guidës audio që të këshillohet me të verbrit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara përgjatë gjithë ndërtimit të guidës. Kjo nuk duhet të jetë thjesht një punë e kryer kur guida të ketë mbaruar së shkruari, por duhet të ndodhë gjatë kohës që ajo është duke u ndërtuar për t'u siguruar që është e përshtatshme dhe e vlefshme për njerëzit që do ta përdorin.

Komentet nga procesi i këshillimit mund të nënkuptojnë që duhet të bëni ndryshime në guidën audio; kjo mund të kërkojë kohë e para.

Tekstet

Duhet të siguroheni që një përshkrues i cili ka përvojë në përshkrim për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar ndihmon në ndërtimin e tekstit, sidomos nëse guida audio do të prodhohet enkas për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar.

Informacioni për orientimin

Çdo informacion që jepet në guidë për orientimin e njerëzve përreth muzeut duhet të ndërtohet së bashku me të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar. Është ide e mirë t'u kërkohet njerëzve me përvoja të ndryshme humbjeje të shikimit që ta provojnë, për t'u siguruar që është e saktë, e dobishme dhe e sigurt.

Ky informacion nuk zëvendëson stafin e dobishëm, shenjat e mira dhe hartat me shkronja të mëdha që mund të preken.

Riprodhime me prekje të ekspozitave arkeologjike dhe historike

Lejla Mahmic, Muzeu i Qytetit të Zenicës, Bosnje dhe Hercegovinë

Në ekspozitat tona të përhershme janë bërë vetëm disa ndryshime të vogla për ta bërë muzeun të aksesueshëm nga njerëzit me aftësi të kufizuara. Për shembull, ka shumë hapësirë për të lëvizur, por objektet në vitrina nuk shfaqen në nivelin e duhur dhe janë të gjithë të rrethuar nga shumë xham, që reflekton shumë dritë.

Kur kërkonim mënyrën si ta bënim muzeun tonë të më të aksesueshëm kryesisht për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar, na erdhi ideja të marrim disa objekte përfaqësues të paraqitur në ekspozitën tonë arkeologjike dhe historike, dhe t'i kthenim ata në riprodhime me prekje. Kjo do të ishte e dobishme për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar si edhe për njerëz me aftësi të tjera të kufizuara, por mund të jetë e dobishme dhe interesante edhe për fëmijët dhe vizitorë të tjerë sepse ata mund të vendosin duart mbi objekte dhe t'i manipulojnë ata. Kjo nuk mund të bëhet me objektet origjinale në ekspozita.

Gjetëm një skulptor i cili ishte në gjendje të punonte, ose duke përdorur skica të objektit (sepse disa ekspozime ishin thjesht figura dy-dimensionale të objektit, të vendosura në ekspozim të përhershëm), ose duke parë objektin e vërtetë, për të bërë riprodhime të mira dhe reale.

Kontaktua shoqatën lokale të të verbërve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara, dhe i pyetëm se çfarë të kishim parasysh në krijimin e këtyre riprodhimeve. Si rezultat, duhet të siguroheshim se

- riprodhimet të kishin të njëjtat raporte si origjinali, dhe ku ishte e mundur, edhe të njëjtën madhësi;
- riprodhimet të bëheshin me të njëjtin material ose afërsisht të njëjtin material si origjinali, për të ruajtur ndjesinë e materialit origjinal të objektit (për shembull, ndjesia e prekjës së çelikut nëse origjinali është prej çeliku apo ndjesia e prekjës së kockës nëse origjinale është bërë prej kocke);
- riprodhimet të kishin të njëjtat shenja relievi si të origjinalit;
- riprodhimi ishte i sigurt për t'u prekur;
- nëse origjinali ishte gjetur në copa dhe ishte restauruar, edhe riprodhimi duhej të thyhej në copa dhe të "restauruhej", riparohet për të dhënë të njëjtën ndjesi prekjeje si origjinali.

Kështu që, për shembull, bëmë këto riprodhime:



Llambë antike nga ekspozita jonë arkeologjike e përhershme



Lulla otomane nga ekspozita jonë historike e përhershme



Sende qeramike (vazo antike) nga ekspozita jonë arkeologjike e përhershme






Pushkë e vogël nga ekspozita jonë historike e përhershme



Shpatë mesjetare (kjo është krijuar nga një foto dy-dimensionale që është pjesë e ekspozitës sonë arkeologjike të përhershme)



Shpatë otomane (e quajtur jatagan), pjesë e ekspozitës historike të përhershme. Doreza është bërë prej kocke lope, është mbuluar me pjesë çeliku dhe zbukurime prej guri, prandaj këtë pjesë e bëmë me PVC dhe çelik, sepse kur preket jep ndjesinë e prekjës së kockës



Dhe këtu është duke u përdorur...

Pasi ua paraqitëm këto riprodhime të verbërve dhe njerëzve me shikim të kufizuar të komunitetit tonë, ata na thanë që janë të mira dhe që mund t'i ndjejnë vërtet llojet e ndryshme të materialeve, që janë plot me detaje dhe që për ta është hera e parë që mundën realisht të "shohin" diçka në Muze.

Por, nxorëm disa mësimë, më i rëndësishmi që disa prej riprodhimeve janë vërtet të rëndë (sepse kemi përdorur material që i afrohet sa më shumë të jetë e mundur ndjesisë origjinale) dhe si rrjedhojë, nuk janë të përshtatshëm për t'u prekur: ata duhet të mbahen në piedestale të hapur; gjë e cila është pothuajse e kundërta e arsyes përse u krijuan.

Krijimi i prezantimeve PowerPoint të Aksesueshme për të Verbrit dhe Njerëzit me

Shikim të Kufizuar

Audienca juaj

Është e rëndësishme të mbani mend se, kushdo të cilëve u flisni, janë njerëz të zakonshëm si ju dhe që disa prej tyre mund të kenë aftësi të kufizuara. Kështu që duhet të siguroheni që prezantimi juaj nuk paraqet pengesa për ta. Mbani mend, për shembull, që sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, sot në botë ka rreth 314 milionë njerëz me shikim të kufizuar. 37 milionë janë të verbër, 124 milionë kanë shikim të ulët edhe me syze dhe 153 milionë kanë probleme me shikimin në distancë. Gjithashtu, pranohet gjerësisht se deri në 4% e popullsisë ka disleksi të konsiderueshme. Audienca juaj mund të ketë njerëz nga të gjitha këto kategori.

Këto udhëzime ju ndihmojnë të siguroheni që prezantimi dhe teknika e paraqitjes suaj të jetë sa më të aksesueshme të jetë e mundur për audiencën tuaj.

Zgjidhje praktike

Përdorni një plan me kontrast të lartë i cili shihet me lehtësi nga fundi i një dhome të madhe. Ne rekomandojmë ose tekst të errët mbi një sfond të bardhë ose tekst të bardhë mbi një sfond të errët. Sfondi shumë i bardhë mund të krijojë shkëlqim të parehatshëm për audiencën.

Nuk është e mundur të përcaktohet kombinimi më i mirë i mundshëm i lexueshëm për të gjithë pasi preferencat e secilit janë të ndryshme. Mbajeni sfondin vetëm me një ngjyrë dhe mos përdorni imazhe në sfond pas tekstit.

Madhësia e rekomanduar e gërmaxhe dhe sasia e tekstit për çdo slajd

Është mirë që në një slajd të ketë vetëm disa rreshta teksti, apo pika plani, në mënyrë ideale jo më shumë se pesë deri në shtatë rreshta, dhe vetëm rreth pesë apo gjashtë fjalë për radhë, të rreshtuara nga e majta, me fjalë të tjera, jo në qendër. Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme midis rreshtave për të parandaluar efektin e “grumbullimit” gjatë leximit.

Ne rekomandojmë jo më shumë se gjashtë rreshta teksti me hapësirë prej 1,5 midis rreshtave në çdo slajd, me hapësirë anash prej 2,5 cm në të katërta anët për kreun dhe fundin e faqes, etj. Kjo zakonisht është e mundur me gërma me madhësi 48 pt, dhe



Nëse e prezantoni informacionin qartë për njerëz me shikim të kufizuar, ai do të jetë më i lehtë për t'u lexuar nga shumë të tjerë. Kjo tabelë, nga Projekti Eden në Cornwall, Angli, i përdor shumë mirë fotot – por shkëlqimi dhe reflektimi i pleksiglasit e bëjnë pothuajse të palexueshëm për të gjithë

Përshtatur nga një dokument i Unionit Botëror të të Verbërve (www.worldblindunion.org)

ne rekomandojmë të mos përdoren kurrë gërma me madhësi më të vogël se 32 pt.

Është më mirë të përdoren gërma të mëdha e të vogla së bashku sesa vetëm gërma të mëdha.

Lloji i rekomanduar i gërmave

Përdorni lloje gërmash sans serif si Helvetica, Arial ose Verdana në vend të gërmave si Times New Roman. Këto janë zakonisht më të lehta për t'u lexuar.

Mos përdorni stil me gërma të pjerrëta pasi edhe ky stil është i vështirë për t'u lexuar.

Mbani të njëjtat gërma gjatë gjithë prezantimit. Nëse doni që ta bëni kërcyes një pjesë të tekstit, përdorni për atë tekst gërma me madhësi të madhe, ose stil me gërma të trasha për të tërhequr vëmendjen.

Nëse informacioni në slajd është i rëndësishëm vetëm për atë që prezanton, si për shembull kreu me titullin e prezantimit apo numri i faqes, mbajeni atë sa më të vogël të jetë e mundur për të kursyer hapësirën për informacionin që është i rëndësishëm për audiencën.

Kontrasti i dritës dhe i ngjyrave

Përpiquni të përdorni ngjyra të errëta për sfondin dhe ngjyra të ndezura për tekstin. Për shembull, gërmat e bardha në një sfond blu të errët janë kombinim i mirë. Mos përdorni kombinim të së kuqes me të gjelbrën.

Shifrat dhe grafikët

Nëse keni shifra dhe grafikë, mbajini sa më të thjeshtë të jetë e mundur. Përdorni ngjyra që bëjnë kontrast njësoj siç u tha më sipër për tekstin.

Për shifrat përdorni gërma të llojit sans serif; mos përdorni kurrë më shumë se një lloj gërme për slajd dhe mos përdorni stil gërmash të pjerrëta.

Animimi

Lutemi mbajeni animimin minimal pasi mund të jetë shumë hutues.

E folura gjatë prezantimit të PowerPoint


Kur prezantoheni, shpjegoni formatin e seancës, dhe bëjeni të qartë nëse audienca mund t'ju ndërpresë për të bërë pyetje që ju kërkojnë të shpjegoni diçka.

Është mirë që gjithë teksti i slajdeve të lexohet me zë të lartë. Kjo do të thotë se askush nga audienca nuk duhet të jetë në gjendje të lexojë tekstin për të marrë të njëjtin informacion si gjithë të tjerët. Shifrat dhe grafikët duhet të shpjegohen për të njëjtën arsye. Sigurohuni që ta shpjegoni plotësisht foton apo grafikun, për shembull, 'në këtë slajd rezultatet përmbledhen në një grafik me shiritat. Shiritat në anën e majtë paraqesin të dhënat e gjendjes eksperimentale; shiritat në anën e djathtë ...'

Nëse një pjesë e gjatë teksti është shumë e rëndësishme, përfshini një material për t'u shpërndarë të skicuar me kujdes për ri-lexim të mëvonshëm.

Materialet për t'u shpërndarë

Mund të jetë e dobishme nëse i jepni materialet për shpërndarje në fillim të seancës dhe



kjo do t'i tregojë audiencës nëse duhet të mbajë shënime.

Nëse bëni kopje bardhë e zi të slajdeve dhe kontrasti nuk është shumë i qartë, kjo mund të nënkuptojë që ndoshta as kontrasti në versionin origjinal me ngjyra nuk është shumë i qartë.

Sigurohuni që keni kopje të plota të slajdeve në rast se ndonjëri dëshiron ta ndjekë prezantimin por nuk mundet t'i shohë slajdet në ekran.

Mbajeni materialin në formate të aksesueshëm, të tillë si Braille, CD, ose në kartë memorieje që anëtarët e verbër të audiencës ta shkarkojnë në laptopë. Kjo nënkupton që, të paktën nëse një person i verbër nuk mundet ta shohë prezantimin në PowerPoint, apo të lexojë materialet e shpërndarë, ai do të ketë të njëjtin akses në informacion si bashkë-pjesëmarrësit në prezantim.

Nëse e shfaqeni, thuajeni. Imagjinoni sikur po e dëgjoni prezantimin tuaj në radio; a do të ishte i kuptueshëm dhe a do të kuptohej plotësisht ajo që po transmetohet?

Hapja e artit dhe muzeve ndaj njerëzve që nuk dëgjojnë

Pamundësia për të dëgjuar shpesh është e padukshme dhe ne nuk e dallojmë. Është e rëndësishme të kuptohet që njerëzit që nuk dëgjojnë janë të ndryshëm në mënyrat e mëposhtme:

- sa dëgjojnë
- si dëgjojnë
- sa kohë ka që kanë humbur dëgjimin
- mosha kur kanë humbur dëgjimin
- shkaku i humbjes së dëgjimit
- si komunikojnë
- sa mbështetje kanë
- si e shohin veten dhe pamundësinë e tyre për të dëgjuar

Është e rëndësishme të jemi të informuar për këto ndryshime për çështje që lidhen me komunikimin bazë.

Grupet e ndryshme kryesore të njerëzve që nuk dëgjojnë janë si më poshtë vijon:

Të shurdhër

Persona të shurdhër janë (zakonisht) ata që nuk dëgjojnë që në moshë të hershme ose që nga lindja. Ata përdorin zakonisht një formë të Gjuhës së Shenjave, e cila mund të jetë gjuha e tyre e parë. Prandaj shumica e shohin veten si pjesë të një minoriteti kulturor dhe gjuhësor dhe jo si persona me aftësi të kufizuara. Është e rëndësishme të mbahet mend se aftësitë e tyre në gjuhën që flitet në vendin tuaj mund të jenë mjaft të kufizuara.

Të shurdhuar apo shurdhmemecë

Të shurdhuarit dhe të shurdhrit që flasin zakonisht nuk përdorin ndonjë Gjuhë Shenjash dhe gjuha e tyre e parë do të jetë zakonisht njëra nga gjuhët e vendit tuaj. Ata mund të mos ndihen shumë të lidhur me personat që nuk dëgjojnë të cilët e shohin veten si pjesë të një minoriteti kulturor dhe gjuhësor. Aparatet e dëgjimit nuk ndihmojnë shumë. Zakonisht ky grup vlerëson më tepër kthimin e së folurës në tekst, prandaj transkriptet (versionet e shkruar të asaj që flitet) mund të jenë të dobishëm.

Personat me dëgjim të rënduar/Përdoruesit e aparateve të dëgjimit

Në këtë grup bëjnë pjesë shumë njerëz. Personat në moshë të madhe kanë prirjen ta humbasin dëgjimin si rezultat i plakjes (ose nëpërmjet ekspozimit të veçantë ndaj zhurmës), dhe kanë nevojë për aparate dëgjimi në mënyrë që të



Të gjithë duan të kenë mundësi të prekin, të luajnë, të provojnë gjëra, por kjo lloj përvojë fizike mund të jetë vërtet e rëndësishme për njerëzit me dëgjim të kufizuar

*Bazuar në një artikull të
Deafworks
(www.deafworks.co.uk) dhe i
përdorur me leje*

deafworks^s

përdorin dëgjimin dhe të folurin për të komunikuar me të tjerët.

Stafi i muzeut

Stafi i muzeut tuaj ka shumë rëndësi në përfshirjen e njerëzve me dëgjim të kufizuar në çdo gjë që ofroni. Stafi ka nevojë për mbështetje që të sigurohet se

- qëndrimi ndaj dëgjimit të kufizuar e humbjes së dëgjimit *dhe*
- njohja e pajisjeve dhe burimeve dhe siguria e tyre në mënyrën si i përdorin

janë të përshtatshme për njerëzit me dëgjim të kufizuar.

Stafi ndonjëherë u përgjigjet negativisht njerëzve me dëgjim të kufizuar: ose janë nervozë dhe nuk i kuptojnë, në vend që të jenë të qetë dhe të normalë. Një trajnim për ndërgjegjësimin ndaj dëgjimit të kufizuar i stafit që merret drejtpërsëdrejti me publikun, mund të jetë i dobishëm. Ky trajnim mund ta ndihmojë stafin të kuptojë se si mund të komunikojë në mënyrë efektive me një vizitor me dëgjim të kufizuar. Për shembull, ata do të mësojnë se është e rëndësishme

- të mos lëvizin kur flasin
- t'i bien shkurt asaj që duan të thonë dhe si ta thonë atë
- t'i marrin çështjet me radhë
- të sigurohen që fytyra e tyre është e ndriçuar mirë
- të mbajnë kontakt me sy
- të mos qëndrojnë shumë larg nga personi me dëgjim të kufizuar
- të flasin qartë pa bërtitur
- të sigurohen që nuk e kanë gojën të fshehur, në mënyrë që të mund t'u lexohen buzët.

Ka disa gjëra që duhen thënë edhe për leximin e buzëve:

- shprehja e fytyrës suaj është e rëndësishme
- nuk ka dobi nëse flisni shumë shpejt apo shumë ngadalë
- thekset e panjohur mund të jenë të vështirë
- përdorimi i gjesteve mund të jetë i dobishëm.

Disa prej këtyre janë gjëra që nuk mund të ndryshohen por do të ishte e dobishme ta dini që është e vështirë t'ju lexohen buzët sepse, për shembull, keni një theks i cili nuk është i zakonshëm në muze, ose sepse keni mjekër.

Aksesueshmëria

Është gjithashtu e rëndësishme që ta bëni vendndodhjen të aksesueshme. Kjo mund të ketë lidhje me

- sistemet të cilat amplifikojnë zërin e folësit, duke e bërë më të thjeshtë për njerëzit që përdorin aparate dëgjimi. Këto mund të jenë të dobishme në salla leksionesh apo galeri (shpesh si një qark induksioni i vendosur përreth dhomës). Ofrohen gjithashtu edhe sistemet e lëvizshme të cilat u mundësojnë personave me dëgjim të kufizuar të lëvizin, për shembull gjatë një bisede në galeri;
- telefonat me ekrane që shfaqin tekst (tekstfon/minikom) – këta i lejojnë njerëzit me dëgjim të kufizuar të bëjnë prenotime dhe pyetje pa përdorur telefonin e zakonshëm;
- faksi mund të jetë gjithashtu shumë i dobishëm për njerëzit me dëgjim të kufizuar;

- e-maili;
- telefoni me volum të shtuar;
- kontrolloni nëse telefoni juaj publik ka amplifikator;
- alarme zjarri me drita pulsuese, të cilat janë të domosdoshme për zonën kryesore publike;
- si edhe staf i trajnuar për të përdorur këto pajisje.

Mund të bëhen gjithashtu rregullime në ndërtesën e muzeut apo të galerisë për ta bërë atë më të lehtë për t'u përdorur nga njerëzit me dëgjim të kufizuar:

- ndriçim i mirë për të mundësuar leximin e lehtë të buzëve – ndriçimi i mirë, i njëtrajtshëm dhe pa hije është më i miri;
- grila në dritare për të ndaluar dritën verbuese të diellit pa e errësuar dhomën, duke dhënë kushte të mira ndriçimi për lexim buzësh;
- etiketa të qarta, me tabela dhe shenja të qarta;
- skema me ngjyra: kjo për arsye se sfondet e mira janë të rëndësishme për lexuesit e buzëve;
- duhet marrë në konsideratë akustika pasi hapësirat jehuese mund t'ia bëjë jetën të vështirë personit me dëgjim të kufizuar.

Ekspozimet e Përhershme dhe të Përkohshme

Kur krijoni ekspozimet tuaja të përhershme dhe të përkohshme, është e rëndësishme të mendoni për çështjet në vijim:

- të siguroheni që ekspozitat janë interaktive dhe vizuale;
- t'i bëni sistemet e zërit të dëgjueshme për njerëzit me dëgjim të rënduar;
- titrat për një shfaqje fotosh apo videosh;
- të vini në dispozicion transkripte për aktivitetet me zë;
- të vini në dispozicion detaje për çdo efekt dhe regjistrim zëri të përdorur për "t'i dhënë gjallëri" disa dhomave apo ekspozitave (këto mund të jenë në trajtën e një materiali për shpërndarje): këto duhet të reklamohen qartë.


Përveç përmirësimit të disa karakteristikave të përhershme të jetës së muzeut si stafi, ndërtesa dhe pajisjet, shumë muze kanë zbuluar se përfshirja e aktiviteteve për dëgjimin e kufizuar i ka ndihmuar në zhvillimin e kësaj audience të re. Nëse e bëni këtë, do t'ju duhet të mendoni për:

- të organizuar një interpret të gjuhës së shenjave;
- të ofruar një "mikpritës" i cili mund të komunikojë lehtësisht me gjithë llojet e njerëzve;
- të ofruar një folës me buzë ose një ekran që kthen të folurën në tekst, nëse aktiviteti synon të përfshijë njerëz të shurdhuar dhe me dëgjim të rënduar;
- t'u siguruar që keni ndriçim të përshtatshëm për të pasur mundësi të shihni guidën ose interpretin, ndërkohë që nuk e dëmtoni ekspozitën;
- t'u siguruar që grupi me dëgjim të kufizuar ka vijë pamore të qartë e të pandërprerë që u mundëson të shohin guidën apo folësin;
- t'u siguruar që keni një përmbledhje apo tekst në dispozicion për bisedat apo leksionet.

Reklamimi për aktivitetin

Për aktivitete specifike të dëgjimit të kufizuar, mund t'ju duhet të mendoni për forma të reja si të arrini vizitorë të mundshëm me dëgjim të kufizuar:

- duke reklamuar në çdo buletin specialistësh;

- 
- duke krijuar një listë postimi të vizitorëve të rregullt me dëgjim të kufizuar;
 - duke krijuar një rrjet të njerëzve me dëgjim të kufizuar të cilët mund ta përhapin lajmin;
 - duke filluar këshillime me njerëzit e shurdhuar apo me dëgjim të rënduar, për t'u siguruar që po i shpenzoni kohën dhe paratë në mënyrë të dobishme.

Një listë bazë për akses në muze

Të shkosh në muze

Kini parasysh	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A gjendet muzeu juaj pranë transportit publik?			
A mund të zbresin vizitorët nga një automjet pranë hyrjes?			
A ka një rrugicë të qartë të niveluar që çon tek hyrja kryesore?			
A ka vend për të parkuar pranë hyrjes kryesore?			
Hyrja juaj kryesore ka platformë të pjerrët apo është e niveluar?			
Nëse keni platformë të pjerrët, a është të paktën 1200 mm e gjerë (800 mm nëse është e lëvizshme), a ka parrak në të paktën 1 krah (2 nëse është më shumë se 2 m e gjatë) dhe a ka pjerrësi prej jo më shumë se 1:12 (deri në 2 m gjatësi), 1:15 (deri në 5 m gjatësi) ose 1:20 (deri në 10 m gjatësi)?			
Nëse keni shkallë, a ka parrakë të vazhdueshëm në të dy krahët, me një parrak poshtë mesit nëse shkallët janë më shumë se 1800 mm të gjera dhe a ka parraku një lartësi prej jo më shumë se 900 mm nga niveli i shkallës?			
Nëse jo, a keni një hyrje të niveluar apo me platformë të pjerrët, dhe nëse po, a sinjalizohet me tabelë?			
A është dera kryesore e lehtë për t'u hapur (për shembull a mbahet hapur apo është automatike?)			
Nëse jo, a keni zile tek dera apo mund të shohë stafi nëse dikush po pret të hyje?			
A është dera kryesore të paktën 800 mm e gjerë?			
A ka akses të niveluar apo me platformë të pjerrët në zonën tuaj kryesore të receptionit?			
A është zona e receptionit mikpritëse për njerëzit me aftësi të kufizuara (për shembull, a ka banaku një pjesë të ulët?)			

Të lëvizësh në muze

Kini parasysh	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A janë të gjitha zonat të aksesueshme nga rrugë të niveluara apo me platformë të pjerrët, apo me ashensor?			
Nëse ka platformë të pjerrëta në muze, a janë të paktën 1200 mm të gjera (800 mm nëse janë të lëvizshme), a kanë parrak në të paktën 1 krah (2 nëse janë më shumë se 2 m të gjata) dhe a kanë pjerrësi prej jo më shumë se 1:12 (deri në 2 m gjatësi), 1:15 (deri në 5 m gjatësi) ose 1:20 (deri në 10 m gjatësi)?			
Nëse keni shkallë, a ka parrakë të vazhdueshëm në të dy krahët, me një parrak poshtë mesit nëse shkallët janë më shumë se 1800 mm të gjera dhe a ka parraku një lartësi prej jo më shumë se 900 mm nga niveli i shkallës?			
Nëse keni ashensor, a ka butona brenda dhe jashtë që gjenden midis 900 mm dhe 1100 mm nga dyshemeja? A është kabina të paktën 1100 mm x 1400 mm? A ka pasqyrë në murin e pasmë? A ka lajmërim audio?			
A janë të gjitha rrugët të paktën 1100 mm të gjera?			
A janë të gjitha rrugët pa rreziqe?			
A ka vende për t'u ulur në zonat tuaja publike (mundësisht një përzierje me dhe pa mbështetëse krahësh, dhe të gjitha me ndenjës jo me shumë se 900 mm nga dyshemeja?)			
A janë shënuar qartë të gjitha zonat me xham?			
A janë të gjitha dyert të paktën 800 mm të gjera?			
A është ndriçimi i njëtrajtshëm dhe me nivel të mirë në të gjithë muzeun?			
A keni shenja të mira përreth muzeut, duke përdorur foto si edhe fjalë?			
A është i lehtë, i drejtpërdrejtë dhe i sigurt evakuimi i emergjencës për personat me aftësi të kufizuara? A është trajnuar stafi si të mbështesë njerëzit me aftësi të kufizuara në rast emergjence?			

Ambientet në muze

Kini parasysh	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A keni tualete të caktuar për njerëzit me aftësi të kufizuara?			
A është kabina të paktën 1400 mm x 2200 mm?			
A sinjalizohen tualetet qartë me tabela?			
Nëse keni ambiente freskuese, a janë të lehtë për t'u përdorur nga njerëzit me aftësi të kufizuara (për shembull, a ofroni pipëza pijesh, a mund t'i lëvizin njerëzit karriget, a keni jastëkë?)			
A keni qark induksioni në muze?			
A keni në dispozicion syze apo fletë zmadhuese për vizitorët?			
A bëhen lehtë të disponueshme ndenjëset e lëvizshme?			
A i lejoni qentë ndihmës në muze?			

Marketingu i muzeut

Kini parasysh	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A e publikoni muzeun në materiale të shkruar?			
Nëse po, a ndiqni udhëzime të qarta për printim?			
A e publikoni muzeun në faqe interneti?			
Nëse po, a i keni ndjekur udhëzimet për faqet e aksesueshme të internetit?			
A përmban informacioni juaj reklamues informacion aksesit?			
A mund të zgjedhin njerëzit mënyrën si të kontaktojnë muzeun (për shembull 'telefon, email, tekst)?			

Një listë aksesi bazë për projektimin e ekspozitave

Përdoreni këtë listë për të udhëzuar mendimin tuaj krijues kur projektoni ose ri-projektoni një ekspozitë. Fotokopjojeni këtë listë dhe përdoreni për çdo ekspozim apo ekspozitë.

Hapësirat e ekspozitës

Kini parasysh	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A ka akses të niveluar, me platformë të pjerrët apo me ashensor për në ekspozitë?			
A ka hapësirë të mjaftueshme midis vitrinave dhe mobilieve për njerëzit që përdorin karrige me rrota apo bastunë (rrugicat duhet të jenë 1100 mm të gjera?)			
A ka objekte të rrezikshëm mbi apo të dalë në rrugicë, a janë shënuar ata qartë?			
A mbahet në minimum niveli i zhurmës?			
Nëse ju duhet të keni zhurma të forta si pjesë të ekspozitës, a i lajmëroni vizitorët për këtë?			
A e shmangni mbivendosjen e zërit nga një ekspozitë apo hapësirë tek tjetra?			
A mbahet niveli i ndriçimit i mjaftueshëm për t'i lejuar njerëzit të shohin qartë objektet?			
A është ndriçimi i qëndrueshëm në të gjitha hapësirat?			
Nëse ju duhet ta mbani ndriçimin të ulët, a i lajmëroni njerëzit për këtë?			
A ofroni vende për t'u ulur në dhomat e ekspozitave (mundësisht një përzierje me dhe pa mbështetëse krahësh – dhe të gjitha me ndenjëset të paktën 500 mm nga dyshemeja?)			
A bëhen lehtë të disponueshme ndenjëset e lëvizshme?			

Ekspozimet

Kini parasysht	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A ekspozohen objektet në vitrina në një lartësi nga e cila mund t'i shohin përdoruesit e karrigeve me rrota (jo më shumë se 900 mm nga dyshemeja)?			
A ekspozohen objektet në mure në një lartësi nga e cila mund t'i shohin përdoruesit e karrigeve me rrota (midis 1220 mm dhe 1600 mm nga dyshemeja)?			
Nëse objektet janë në piedestale, a janë këta 1000 mm ose më pak nga dyshemeja?			
A kanë vitrinat ekspozuese një pjesë të futur për gjunjët në mënzrë që t'u afrohen përdoruesit e karrigeve me rrota (750 mm të larta, 900 mm të gjera dhe 400 mm të thella)?			
A përdorni xham jo-reflektues në vitrinat ekspozuese?			
A bëjnë kontrast me materialin e sfondit objektet në vitrinat ekspozuese?			
A ka modele apo fotografi të zmadhuara të objekteve të vogla?			
A ka ndonjë mënyrë alternative për të parë ekspozitën nga njerëz që nuk mundin, ose nuk duan, të arrijnë ekspozimet (për shembull, fotografi me cilësi të lartë në kompjuter, apo një vizitë virtuale në internet)			
Nëse keni interaktivë, a janë udhëzimet të qarta dhe të thjeshta për t'u kuptuar?			
A mund të drejtohen të gjithë interaktivët me një dorë me grusht të mbyllur?			
A ka informacion audio në ekspozime, a ka qarqe induksioni?			
A ka informacion audio në ekspozime dhe a ofrohet ai edhe në mënyrë vizuale (për shembull, titra në video, transkripte të tregimit të regjistruar)?			
A ka disa mënyra për të parë koleksionet tuaja (për shembull, për shembull, fotografi me cilësi të lartë në kompjuter, apo një vizitë virtuale në internet)?			

Etiketimi dhe katalogët

Kini parasysht	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
A është i gjithë teksti i paneleve dhe prezantimeve kryesore të paktën 24 pt?			
A është i gjithë teksti në tabela të paktën 18 pt?			
A është i gjithë teksti me gërma sans serif, pa hije?			
A është i gjithë teksti i rreshtuar majtas (jo i drejvizuar plotësisht)?			
A bën teksti kontrast të mirë me sfondin?			
A e keni shmangur printimin e tekstit mbi imazhe?			
A ofrohet version audio i tekstit?			
A ofroni etiketa në alfabet Braille?			
A mund t'i afrohen tekstit vizitorët?			
A ka ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar tekstin?			
A janë të qëndrueshme vendosja dhe skicimi i etiketave në të gjithë ekspozitën?			
A janë vendosur etiketat dhe teksti midis 1200 mm dhe 1600 mm nga dyshemeja?			
A ofroni etiketa dhe tekst në formë fletash që vizitorët t'i mbajnë me vete?			
A ofrohen katalogët në një sërë formatesh?			
A i përmbushin katalogët tuaj udhëzimet bazë për printim të qartë?			

Përmbajtja dhe aktivitetet e ekspozitës

Kini parasysht	Po	Jo	Veprimi që nevojitet
Nëse në tekstin tuaj përmenden njerëzit me aftësi të kufizuara, a është referencë e përshtatshme dhe e respektueshme?			
Sipas rastit, a paraqitet përvoja e njerëzve me aftësi të kufizuara në ekspozitë?			
Sipas rastit, a jeni këshilluar me njerëz me aftësi të kufizuara kur keni kuruar ekspozitën?			
Nëse jeni duke programuar seminare, biseda apo aktivitete të tjera, a përfshihen njerëzit me aftësi të kufizuara si folës, kontribues, artistë?			
A ofroni interpretim të Gjuhës së Shenjave për biseda, seminare dhe aktivitete të tjera?			
A keni qark induksioni për njerëzit që mbajnë aparate dëgjimi?			
A ka përvoja shumë-shqisore në ekspozitat tuaja?			

Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Shembuj të Praktikës së Mirë

Megjithëse ky shkrim mbi xham nuk është shumë i qartë, informacioni ("galeria është 37 shkallë më poshtë") është shumë i dobishëm



Vendet për t'u ulur janë vërtet të dobishme



Është mirë t'u japësh njerëzve mundësinë të prekin objekte në muze



Ky kabinet ekspozimi është i aksesueshëm sepse është i ulët dhe ka shumë hapësirë ku mund të afrohet një përdorues i karriges me rrota



Këto janë tabela të qarta që përdorin figura ashtu si edhe fjalë



Disa njerëz mund të kenë nevojë të marrin hua një karrige me rrota



Shumë vende për t'u ulur dhe informacion në nivel të ulët dhe kënd të përshtatshëm



Një mikpritje shumë e qartë me një ndenjësë për të pushuar



Karrigia me rrota është pjesë e ekspozitës mbi teknologjinë, jo mbi aftësitë e kufizuara



Gjëra që mund të bëhen në lartësi të ulët



Përdorimi i të gjitha shqisave është një mënyrë e dobishme për të përfshirë shumë njerëz



Jepuni njerëzve shumë mundësi të ndryshme për t'u përfshirë dhe për të dhënë komente



Ky ekspozim përdor një objekt të përshtatshëm si pjesë e interpretimit



Përdorimi i punës së një artisti me aftësi të kufizuara për të treguar këndvështrimet e ndryshme mbi trupin njerëzor



Të gjithëve u pëlqen të mundën të marrin sendet dhe të luajnë me ta



Ofrimi i një xhami zmadhues nënkupton që të gjithë marrin maksimumin nga vizita e tyre



Vizitat me prekje me përshkrim audio janë të kërkuara nga shumë të verbër dhe njerëz me shikim të kufizuar




Krijimi i një harte me prekje mund të jetë i lehtë



Κjo hartë është e aksesueshme për shumë njerëz



Informacioni për oraret e pritjes mund të jetë shumë i dobishëm për njerëzit me aftësi të kufizuara - dhe të tjerë



Kjo shenjë është shumë e qartë



Përdorimi i një pasqyre me gjatësi të plotë nënkupton që mund ta përdorin të gjithë



Përse të shohim aftësitë e kufizuara?


Njerëzit me aftësi të kufizuara përjetojnë diskriminim dhe paragjykim. Kjo ndikon në arsimimin dhe formimin tonë, në jetën tonë shoqërore dhe në mundësitë për të gjetur punë. Shumë njerëz me aftësi të kufizuara jetojnë përditë me probleme të krijuara nga të tjerët që kanë pritshmëri të ulëta nga ne; ëndrrat dhe aspiratat tona ndryshojnë dhe, në heshtje, nuk merren parasysh shpresat tona për formim, punë dhe karrierë, ose tallen haptazi.

Dhe megjithatë, njerëzit me aftësi të kufizuara janë burim për shoqërinë, i nevojshëm për çdo shoqëri që dëshiron të funksionojë mirë. Ideja e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara, që pengesat për akses të ulen, nuk është thjesht një çështje të drejtash civile, megjithëse lidhet me drejtësinë dhe të drejtat, por është edhe një çështje cilësie. Çdo muze që kërkon të përjetojë dhe të ofrojë cilësi, duhet të sigurohet që njerëzit me aftësi të kufizuara të kenë akses të vërtetë në ndërtesë, në koleksione, në objekte dhe shërbime të çdo niveli. Në këtë mënyrë, muzeu sigurohet që po prek një rezervë më të gjerë aftësish, talentesh, përvoja dhe informacioni sesa po të qëndronte tek grupet e sigurt dhe të njohur të njerëzve.

Muzetë dhe vendet e trashëgimisë luajnë një rol të rëndësishëm në shoqëri: ata pasqyrojnë se si është shoqëria dhe ndikojnë në të. Të gjithë, sidomos të rinjtë, i marrin modelet tona të roleve me anë të muzeve, trashëgimisë dhe historive që u tregohen për botën. Ne mësojmë për njerëzit që janë të pranueshëm, të respektuar dhe të vlerësuar në shoqërinë tonë. Prandaj është thelbësore që në muze njerëzit me aftësi të kufizuara të jenë të dukshëm.

Njerëzit me aftësi të kufizuara janë pjesë e audiencës së mundshme të muzeve. Nëse i përjashtojmë njerëzit me aftësi të kufizuara nga zonat e trashëgimisë apo artit, rrezikojmë të humbasim një mundësi marketingu.

Është thelbësore që njerëzit me aftësi të kufizuara të kenë akses në krijimin e artit dhe në përdorimin e organizatave të artit dhe trashëgimisë për të treguar historinë e tyre. Nëse nuk i lejojmë njerëzit me aftësi të kufizuara që ta bëjnë këtë, atëherë trashëgimia jonë nuk do të jetë një pasqyrim i vërtetë ose i plotë i kulturës sonë. Komunitetet pasurohen kur të gjithë nxiten të tregojnë historinë e tyre dhe dëgjohen.



Muzeu juaj mund të tregojnë histori të njerëzve me aftësi të kufizuara. Kjo mund të bëhet në ekspozime të veçanta për njerëzit me aftësi të kufizuara, ose si pjesë e ekspozimeve mbi tema të tjera

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara

Hyrje

Lëvizja e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara filloi gjatë gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Mendimtarët dhe aktivistët brenda Lëvizjes krijuan një formë të re të menduarit mbi aftësitë e kufizuara, e cila përqendrohet në pengesat e njerëzve me aftësi të kufizuara në vend të aftësive të kufizuara si gjendje shëndetësore. Ata e quajtën modeli shoqëror, dhe formën e vjetër të menduarit e quajtën modeli individual ose mjekësor.

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara bën kontrast me modelin individual të aftësive të kufizuara, i cili ka përcaktuar të menduarin, politikat dhe praktikat për të paktën dyqind vjet, e ndoshta më shumë.

Modeli individual

Brenda modelit individual të aftësive të kufizuara, vështirësitë e njerëzve me aftësi të kufizuara shihen si rezultat i drejtpërdrejtë i dëmtimit (gjendja e tyre shëndetësore).

Kur njerëz si politikanët apo drejtuesit mendojnë për aftësitë e kufizuara në këtë mënyrë, ata i përqendrojnë përpjekjet e tyre në 'kompensimin' e njerëzve me dëmtime për atë që 'nuk shkon' me trupin e tyre dhe në 'ndihmën' që njerëzit me aftësi të kufizuara t'ia dalin.

Modeli individual i aftësive të kufizuara ndikon edhe në mënyrën se si mendojnë për vete njerëzit me aftësi të kufizuara. Shumë njerëz me aftësi të kufizuara e besojnë mesazhin negativ sipas të cilit të gjitha problemet e njerëzve me aftësi të kufizuara burojnë nga mospasja e një trupi 'normal'. Edhe njerëzit me aftësi të kufizuara mund të bëhen të besojnë se gjendja e tyre shëndetësore i ndalon të marrin pjesë në aktivitete shoqërore në mënyrë automatike .

Modeli individual është një model deficiti; kryesisht ai përshkruan çfarë nuk shkon, si personi është i ndryshëm nga një person i shëndetshëm 'normal', dhe mënyrat e pabarazisë.

Ai përshkruan

- çfarë munden dhe nuk munden të bëjnë;
- çfarë do të vazhdojnë të munden dhe të mos munden të bëjnë;
- për çfarë kanë nevojë;
- mënyrën e jetës që do të kenë.



Unë kufizohem nga shkallët, jo nga gjendja ime shëndetësore. Nëse vendosni ashensor, kjo do të nënkuptojë që këto shkallë nuk më kufizojnë

Modeli shoqëror

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara bën dallimin e rëndësishëm midis 'dëmtimit' dhe 'aftësisë së kufizuar'.

Modeli shoqëror është krijuar nga njerëzit me aftësi të kufizuara, të cilët mendojnë se modeli individual nuk ofron një shpjegim të përshtatshëm për mënyrën se si përjashtohen nga shoqëria njerëzit me aftësi të kufizuara. Përvojat personale u kanë treguar se shumica e problemeve të tyre nuk shkaktohen nga dëmtimet që kanë, por nga mënyra si është organizuar shoqëria.

Kështu që, në modelin shoqëror të aftësive të kufizuara, përcaktimet kyç janë:

Dëmtimi

Një dëmtim, sëmundje apo gjendje e cila shkakton efekt afatgjatë në pamjen fizike dhe / ose problem funksionimi tek individi. Efekti është i ndryshëm nga ai që përjetojnë shumica e njerëzve.

Aftësitë e kufizuara

Kufizimi i njerëzve me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në shoqëri në të njëjtin nivel si të tjerët, për shkak të pengesave shoqërore dhe mjedisore.


Aftësia e kufizuar është provuar se shkaktohet nga 'pengesat' të cilat i marrin shumë pak ose fare në konsideratë njerëzit që kanë dëmtime.

Shoqëria i kufizon njerëzit që kanë dëmtime sepse mënyra në të cilën është krijuar i pengon njerëzit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në jetën e përditshme. Nga kjo rrjedh që, nëse njerëzit me aftësi të kufizuara do të kenë mundësi t'i bashkohen shoqërisë së zakonshme, atëherë mënyra si është organizuar kjo e fundit duhet të ndryshojë. Këtë ndryshim mund ta sjellë heqja e pengesave që përjashtojnë njerëzit që kanë dëmtime.

"Duhet ngritur dy çështje themelore në lidhje me modelin individual të aftësive të kufizuara. Së pari, ai e vendos 'problemin' e aftësisë së kufizuar tek individi dhe së dyti, ai e sheh shkakun e këtij problemi të burojë nga kufizimet e funksionimit apo humbjet psikologjike, të cilat supozohet se rrjedhin nga aftësia e kufizuar.

Origjina, zhvillimi dhe artikulimi i modelit shoqëror të aftësive të kufizuara nga vetë njerëzit me aftësi të kufizuara është një refuzim i të gjithë këtyre bazave (Oliver, 1990). Ai nuk e mohon problemin e aftësisë së kufizuar por e vendos drejtpërsëdrejti tek shoqëria. Nuk janë kufizimet individuale, të çfarëdo lloji, të cilat janë shkak i problemit, por dështimi i shoqërisë për të siguruar shërbime të përshtatshme dhe për t'u siguruar që nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara merren plotësisht në konsideratë në organizimin e saj shoqëror. Për më tepër, pasojat e këtij dështimi nuk bien thjesht dhe sipas rastit tek individët, por në mënyrë sistematike mbi grupin e njerëzve me aftësi të kufizuara, që e përjetojnë këtë dështim si diskriminim të institucionalizuar nga shoqëria."

Mike Oliver, Paper, paraqitur në Seminarin e Përbashkët të Grupit të Alternativave të Jetesës dhe Njësisë Kërkimore të Kolegjit Mbretëror të Mjekëve, 1990.



Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara ka qenë modeli më çlirues për njerëzit me dëmtime dhe e ka vendosur problemin qartazi jo tek ne, por tek shoqëria.

Është gjithashtu e rëndësishme të shihet se si shoqëria i kufizon njerëzit me dëmtime duke përdorur pamje dhe prezantime të kufizimeve, për shembull fotografi të njerëzve me aftësi të kufizuara, ose gjuhën që përdorim ne për ta. Njerëzit me dëmtime janë të kufizuar, të përjashtuar dhe të trajtuar negativisht nga ata që mendojnë se nuk i kanë trupat të dëmtuar.

Pengesat kufizuese veprojnë në çdo nivel, në rekrutimin për punë, në formim dhe arsim, në sistemet e financimit, në aksesin në ekspozita, në komunikim, në hipoteza, në portretizimin mediatik, në zhvillimin artistik, në mjedisin e punës dhe në rrethet shoqërore të lidhura me të.

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara

Modeli shoqëror ka lidhje me

Shkallët (mjedisi fizik)

dhe

Shikimet (mjedisi i sjelljes)

ku secila ose të dyja mund të kufizojnë dikë që ka dëmtime.


Mbani mend:

	Modeli mjekësor	Modeli shoqëror
Përqendrohet tek	Individi	Mjedisi
Pyet	Çfarë problemi ke?	Çfarë pengesash ka këtu?
Kërkon	Informacion personal	Informacion praktik

Modeli shoqëror

- bazohet në ekspertizën tuaj ekzistuese; me fjalë të tjera, mbështetet në njohuritë tuaja mbi mjedisin ku punoni, jo në informacionin apo aftësitë mjekësore;
- përqendrohet në rrethet tuaja ekzistuese të influencës
- do t'ju sjellë përfitim shumë njerëzve të tjerë përveç atyre që identifikohen si persona me aftësi të kufizuara;
- bazohet tek praktika dhe si rrjedhim zbatohet drejtpërsëdrejti;


e çon barazinë e aftësive të kufizuara në territorin e logjikës, të kujdesit ndaj klientit dhe të menaxhimit.



Modeli shoqëror ka lidhje me "shkallët" dhe "shikimet" [lutemi, ruajini këto fjalë me presje të përmbysura në anglisht]


Modeli mjekësor


Thotë që problemin e ka individi, për shembull:



Modeli shoqëror

Thotë që problemin e ka mjedisi, për shembull:





Modeli shoqëror funksionon – dimë si mund ta bëjmë këtë dhe mund të krijojmë përfshirje dhe barazi.

Modeli mjekësor nuk funksionon – në rastin më të mirë ai mund të ‘kurojë’ ose të përshtatë disa dëmtime individuale por nuk do t’i kurojë asnjëherë të gjitha dëmtimet.

Do të ketë gjithmonë njerëz me dëmtime

Ne *mund* të ndalojmë t’i kufizojmë

Stereotipet e njerëzve me aftësi të kufizuar në media

Profesori Colin Barnes ka studiuar diskriminimin e shoqërisë ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara. Ai thotë se diskriminimi përkeqësohet nga mënyra se si i paraqet media (gazetat, televizioni, radioja) njerëzit me aftësi të kufizuara. Më poshtë është një listë e mënyrave se si paraqiten njerëzit me aftësi të kufizuara, sipas Barnes:

- personi me aftësi të kufizuara si patetik e për mëshirë;
- personi me aftësi të kufizuara si subjekt i dhunës;
- personi me aftësi të kufizuara si i lig dhe i keq;
- personi me aftësi të kufizuara krijon tension ose tmerr;
- personi me aftësi të kufizuara si tejet i gjymtuar;
- personi me aftësi të kufizuara si subjekt i talljes;
- personi me aftësi të kufizuara si armiku i tyre më i keq dhe i vetëm;
- personi me aftësi të kufizuara si barrë;
- personi me aftësi të kufizuara si anormal seksualisht;
- personi me aftësi të kufizuara si i paaftë për të marrë pjesë plotësisht në jetën e komunitetit.

Ndërsa këtu ka udhëzime për portretizim pozitiv.

Portretizime të sakta

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe diskriminimi

Kur portretizohen njerëzit me aftësi të kufizuara në media është e rëndësishme të mbahet mend se publiku i përgjithshëm ka pak njohuri mbi pengesat mjedisore dhe shoqërore që i pengojnë ata të bëjnë jetë të plota dhe aktive. Jetesa me kufizime nënkupton përballjen e përditshme me pengesa mjedisore dhe shoqërore; çdo portretizim i njerëzve me aftësi të kufizuara, në çfarëdo lloj konteksti, i cili nuk pasqyron këtë përvojë është njëkohësisht shumë i pasaktë dhe një shkak madhor i ekzistencës së tyre të vazhdueshme.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe bamirësia

Shmangni përshkrimin e individëve me aftësi të kufizuara si pranues të veprave bamirëse. Tregojini njerëzit me aftësi të kufizuara duke ndërvepruar me njerëz me aftësi të kufizuara dhe jo, njësoj; duke pranuar dhe duke dhënë. Shumë shpesh individët me aftësi të kufizuara paraqiten vetëm si pranues të keqardhjes.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe individualiteti

Shmangni karakterizimet një-dimensionale të njerëzve me aftësi të kufizuara. Kudo që të jepet rasti, portretizojini njerëzit me aftësi të kufizuara si individë me personalitete individuale dhe komplekse, me një diapazon të plotë emocionesh dhe aktiviteteve.



Mund të përfshini historitë e njerëzve me aftësi të kufizuara në çdo ekspozitë, e cila nuk ka pse të jetë mbi aftësitë e kufizuara. Kjo karrige me rrota gjendet në një ekspozim për teknologjinë

nga Colin Barnes, *Pamjet kufizuese dhe media*, Këshilli Britanik i Organizatave të Njerëzve me Aftësi të Kufizuara dhe Ryburn Publishing Ltd, 1992

Ashtu si të gjitha qeniet njerëzore, individët me aftësi të kufizuara përjetojnë një shumëllojshmëri emocionesh, të tilla si lumturia, depresioni, zemërimi, etj., dhe luajnë një shumëllojshmëri rolesh përfshi të dashurisë, prindin, ofruesin, etj. Ky variacion duhet të pasqyrohet saktë në portretizimet mediatike të njerëzve me aftësi të kufizuara.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe e keqja

Shmangni paraqitjen e karakteristikave fizike ose intelektuale të çdo lloji si përcaktuesit e vetëm të personalitetit. Bëni veçanërisht kujdes të mos nënkuptoni lidhje midis dëmtimit dhe së keqes.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe vuajërimi i aftësive të kufizuara

Mos i paraqitni njerëzit me aftësi të kufizuara si objekt kurioziteti. Individët me aftësi të kufizuara duhet të paraqiten si anëtarë të një popullsie mesatare ose si një grup personazhesh. Njerëzit me aftësi të kufizuara në përgjithësi janë të aftë të marrin pjesë në të gjitha aspektet e jetës në komunitet, dhe duhet të portretizohen në një shumëllojshmëri të gjerë rolesh dhe situatash.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe komedia

Një individ me aftësi të kufizuara nuk duhet të tallet apo të bëhet objekt anekdote (të verbrit ose njerëzit me shikim të kufizuar nuk ngasin makina, nuk lozin lojë me hedhje shigjetash dhe nuk përplasen me çdo gjë që u pret rrugën; pavarësisht krijimit të mitit nga disa skenaristë, pak komedianëve dhe reklamuesve të zakonshëm pa skrupuj.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe sensacioni

Gjatë portretizimit të njerëzve me aftësi të kufizuara, shmangni sensacionin. Bëni veçanërisht kujdes me stereotipizimin e njerëzve me aftësi të kufizuara ose si viktimë ose si autorë të dhunës.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe gjymtimi i skajshëm

Rezistojini paraqitjes së personazheve me aftësi të kufizuara me aftësi apo cilësi të jashtëzakonshme. Nëse e bëni këtë, sugjeroni se një individ me aftësi të kufizuara duhet të kompensojë tepër e të bëhet mbinjerëzor për t'u pranuar nga shoqëria.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe forca e vullnetit

Shmangni tipin e historisë me 'buzë të sipërme të shtrënguar' që nënkupton se një personazh me aftësi të kufizuara duhet të ketë vetëm 'vullnetin' dhe 'sjelljen e duhur' për të pasur sukses.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe seksualiteti

Shmangni paraqitjen e njerëzve me aftësi të kufizuara si anormalë seksualisht. Mos i portretizoni njerëzit me aftësi të kufizuara si seksualisht të vdekur ose seksualisht të degjeneruar. Tregojini njerëzit me aftësi të kufizuara në marrëdhënie dashurore duke shprehur të njëjtat nevoja dhe dëshira si njerëzit pa aftësi të kufizuara.

Njerëzit me aftësi të kufizuara dhe popullsia me aftësi të kufizuara

Kur i përshkruani njerëzit me aftësi të kufizuara në media, sigurohuni që ata përfaqësojnë kategoritë e seksit, të racës, të etnisë, të gjinisë dhe të moshës së popullsisë me aftësi të kufizuara në tërësi.

Aftësitë e kufizuara dhe muzetë

“Diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara e dëmton shoqërinë tonë. Nga marrja e arsimimit deri në mundësinë për të lëvizur, nga ndërtimi i një karriere deri në t'u bërit prind, nga dalja me shokët deri tek përdorimi i internetit, njerëzit me aftësi të kufizuara përballen me shumë më tepër sfida sesa bashkëqytetarët e tyre pa aftësi të kufizuara dhe vazhdimisht diskriminohen dhe përjashtohen. Askush nuk mund të sugjerojë seriozisht që njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të kenë më pak mundësi se sa njerëzit pa aftësi të kufizuara por në njëfarë mënyre e gjejmë veten në një situatë ku realiteti, siç e përjetojnë sot njerëzit me aftësi të kufizuara, sugjeron të kundërtën”¹.

Lexojeni përsëri këtë paragraf. Në njëfarë mënyre, ai tregon gjithçka që duhet të mbani mend nga ky artikull.

Demos (të cilët e përshkruajnë veten si “institucion i studimeve mbi demokracinë e përditshme me qendër në Londër”) e përcakton diskriminimin ndaj aftësive të kufizuara si “sjellje diskriminuese, shtypëse ose abuzive që buron nga besimi se njerëzit me aftësi të kufizuara janë inferiorë ndaj të tjerëve”. Autorët, me sarkazëm, shtojnë që “nuk do të gjeni përcaktim në fjalor”².

Unë jam një person me aftësi të kufizuara. Jam gjithashtu trajnuese dhe konsulente që punon me një sërë organizatash, përfshi muzetë, dhe nuk kam asnjë dyshim: shtypja ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara dhe me mungesë dëgjimi (diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara) mbizotëron në shoqërinë tonë dhe është gjerësisht “nën radar”, madje edhe prej individëve dhe organizatave, shqetësimi kryesor i të cilave janë çështjet e barazisë dhe të drejtave njerëzore. Ne tolerojmë një qasje praktike ndaj, dhe një retorikë rreth, aftësive të kufizuara dhe njerëzve me aftësi të kufizuara e mungesë dëgjimi, që është tërësisht e papranueshme dhe që, në vitin 2009, nuk do të tolerohej, po të bëhej fjalë për çështje të tjera lidhur me barazinë.

E di që barazia shkon përtej gjuhës dhe asaj që duket dhe, e di gjithashtu, se ka shumë individë dhe grupe njerëzish të cilët pajtohen me qëndrime tronditëse abuzive e shtypëse. Megjithatë, kur bie fjala tek aftësitë e kufizuara, unë besoj se shumë njerëz as që e dinë çfarë duhet të mendojnë, të bëjnë apo të thonë. Ata madje nuk dinë as se si të bëjnë një bisedë.

¹ *Diskriminimi ndaj aftësive të kufizuara Si ta trajtojmë paragjykimin e fundit*, P. Miller, S. Parker & S. Gillinson, Demos, 2004, fq.11

² *po aty*, fq. 9



Ta bëni muzeun të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara do të thotë të shihni poshtë sipërfaqes dhe të siguroheni që të përfshihet e gjithë organizata

Michèle Taylor, trajnuese dhe konsulente freelance

Ky është një version i ndryshuar i një artikulli që u publikua në angazho, buletini ndërkombëtar i artit pamor dhe edukimit mbi galeritë, nr. 23, pranverë 2009

Si rezultat, ndryshimi sistematik dhe kulturor thjesht nuk po ndodhin.

Në vitin 1976, Unioni i të Dëmtuarve Fizikë Kundër Segregacionit identifikuan një dallim midis dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar. Doli gradualisht dhe u fuqizua Lëvizja e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara, një lëvizje për të drejtat civile, dhe filloi të rritej një politikë e aftësive të kufizuara. Akademikët si Mike Oliver³ filluan ta shprehnin këtë si 'modeli shoqëror i aftësive të kufizuara.

Modeli shoqëror u formulua në kontrast të drejtpërdrejtë me modelin individual, i cili ka dominuar mënyrën se si njerëzit mendonin rreth aftësive të kufizuara dhe njerëzve me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi për shekuj me radhë, dhe i cili qëndron në origjinë të atyre qëndrimeve dhe përvojave të përshkruara më sipër.

Modeli individual është një model deficieti i cili përqendrohet në atë çfarë nuk shkon me individin, si ai ndryshon nga një person 'normal' i shëndetshëm dhe mënyrat se si ai nuk funksionon. Mjekët profesionistë dhe hartuesit e politikave që përdorin modelin individual do të kërkojnë mënyra kompensimi me masa 'speciale' dhe të synuara për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Nënndarjet e modelit individual përfshijnë modelin mjekësor (i cili bazohet në supozimin se personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi duhet të kurohen dhe të bëhen normalë) dhe modelin bamirës (i cili bazohet në supozimin se personat me aftësi të kufizuara, më shumë se sa kontribuues, janë përfitues të burimeve dhe bamirësisë së individëve dhe të shoqërisë).

Nga këndvështrimi i modelit individual, personat kanë aftësi të kufizuara për shkak të arsyeve të tilla si paraliza cerebrale, plagët, dëmtimet në tru, skleroza e shumëfishtë, verbëria dhe epilepsia).

Modeli shoqëror e sfidon këtë këndvështrim.

Dallimi mes dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar është thelbësor. Dëmtimi është një plagë, sëmundje apo gjendje e lindur që shkakton (ose ka gjasa të shkaktojë) një efekt afatgjatë mbi pamjen fizike dhe/ose kufizim të funksioneve që ndryshojnë nga çfarë është normale. Aftësia e kufizuar megjithatë, është ajo me të cilën ndeshet një person me aftësi të kufizuara ose me mungesë dëgjimi gjatë luftës me pengesat që i vendos shoqëria funksionimit të tyre të lehtë dhe të plotë. Ai përshkruan humbjen ose kufizimin e mundësive për të marrë pjesë në shoqëri në të njëjtin nivel si të tjerët, për shkak të pengesave shoqërore, të sjelljes dhe mjedisore.

Modeli shoqëror pra, thotë se njerëzit janë me aftësi të kufizuara për shkak të gjërave të tilla si shkallët, dyert e ngushta, dollapët me vitrina të larta, gërmat e vogla, informacionit në vetëm një lloj formati, tekstit interpretues të shkruar në xham, injorancës, pamjeve jo simetrike dhe paraqitjes së personave të kufizuar dhe gjuhës së ndërlikuar.

Modeli individual mbështet tërësisht supozime dhe pabarazi fuqish të cilat sfidon modelin shoqëror. Ai e ka përjetësuar dhe mbështetur kufizimin e aftësive për shkak se e konsideron dëmtimin (apo 'aftësinë e kufizuar' sipas terminologjisë së tij) si negativ, për të ardhur keq, për t'u kuruar, për t'u pasur frikë dhe për t'u shmangur.

Nuk do ta rekomandoja dot kurrë sa duhet modelin shoqëror si baze për politikën dhe praktikën në muzeun tuaj. Jo sepse është një sistem politik i qëndrueshëm dhe i përkryer, apo sepse është një

³ Për shembull, *Politikat e Aftësive të Kufizuara*, MacMillan 1990

kuadër i fortë filozofik. Singërisht, jam e bindur se nuk është asnjë prej këtyre gjërave⁴. Megjithatë, jam tejet e lidhur me modelin shoqëror si baza e vetme konstruktive për një qasje praktike që funksionon. Kjo nuk është pak pasi është një model fuqizues për organizata që ofrojnë produkte, ambiente dhe shërbime dhe të cilët punësojnë njerëz. Faktorët që shkaktojnë aftësinë e kufizuar brenda modelit individual janë tërësisht jashtë kontrollit të profesionistëve të merren me drejtimin dhe stafin e muzeve dhe galerive. Faktorët që kufizojnë aftësitë e njerëzve brenda këndvështrimit të modelit shoqëror janë aspekte të mjedisit të cilin e krijojnë ata njerëz (ju!), e mbështesin dhe bëjnë pjesë. Për ta thënë hapur, ju e keni nën kontroll ta bëni mjedisin që krijoni kufizues për mua apo jo.

Si përmbledhje:

aty ku modeli individual e lokalizon problemin tek individi, modeli shoqëror e lokalizon tek mjedisi; modeli shoqëror e zhvendos shikimin nga individi tek mjedisi

aty ku modeli individual pyet "çfarë problemi ke?", modeli shoqëror pyet "ku janë pengesat këtu?"

aty ku modeli individual kërkon informacion personal e që nuk ka lidhje, modeli shoqëror kërkon informacion vetëm kur ka nevojë të dijë.

Pyetjet që bën stafi, dhe më në përgjithësi, gjuha, mund të kontrollohet me modelin shoqëror: a do t'ju thotë përgjigja atë që duhet të bëni apo të ndryshoni? Nëse jo, atëherë pyetja ndoshta vjen nga modeli individual me të gjithë pabarazinë dhe shtypjen e tij.

Një efekt anësor i rëndësishëm që haset kur merret seriozisht modeli individual, është që nga heqja e pengesave, në mënyrë të pashmangshme, do të përfitojnë persona të tjerë dhe jo ata me aftësi të kufizuara e mungesë dëgjimi për të cilët pengesat kishin qenë më të dukshme.

Sigurisht që është i rëndësishëm konteksti legjislativ. Këtu në Britani, Akti Kundër Diskriminimit ndaj Aftësive të Kufizuara (1995) dhe ndryshimet e tij të mëvonshme (përfshi ndryshimet në Aktin Kundër Diskriminimit ndaj Aftësive të Kufizuara (2005)) sigurojnë sfondin e detyrimeve ligjore. Në thelb, personave me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi iu dha e drejta e re për të mos u diskriminuar në mënyrë të padrejtë në një sërë fushash, përfshi gjatë ofrimit të produkteve, ambienteve dhe shërbimeve e punësimit. Muzetë, ashtu si organizata të tjera, duhet të sigurohen që të bëjnë 'përshtatje të arsyeshme' në politikën, procedurat, praktikën dhe ambientet e tyre për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi nuk trajtohen në mënyrë më të pafavorshme për shkak të dëmtimit të tyre. Organizatat që janë publike duhet të përmbushin gjashtë detyrimet e përgjithshme të dhëna në ndryshimin e vitit 2005. Këto detyrime u kërkojnë organizatave që të jenë proaktive në sigurimin e barazisë për personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi.

Është e rëndësishme të kuptohet që ka një hapësirë të madhe mes përputhjes me Aktin Kundër Diskriminimit ndaj Aftësive të Kufizuara në njërin anë dhe praktikave më të mira në tjetrën.

Në kuadër më të gjerë përfshihet Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara, e cila u miratua në 13 dhjetor 2006. Ajo aspiron të "sigurojë që gjithë njerëzit me aftësi të kufizuara të shijojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë

⁴ Shihni gjithashtu, për shembull, Liz Crow, "Përfshirja e gjithë jetëve tona: duke rinovuar modelin shoqëror në aftësitë e kufizuara" në *Duke Eksploruar Ndarjen: Sëmundja dhe Aftësia e Kufizuar* C. Barnes dhe G. Mercer (ed), the Disability Press, 1996 për një kritikë mbi kuptimin origjinal të modelit shoqëror.

⁵ Vetë AKDAK përdor gjuhë e cila është pajtohet më shumë me modelin individual.

themelore të njeriut, dhe të promovojë respektin për dinjitetin e tyre të natyrshëm”⁶. Në vijim, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut thotë që “[t]ë gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit, të shijojnë artin...”⁷.

Që të kuptohen të gjitha këto çështje duhet të kuptohet diçka nga detyrimi me të cilin përballlet një organizatë kur punon në mënyrë serioze me persona me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi. Nuk ka të bëjë me zgjidhjet e izoluar, sipas rastit, ndaj problemeve të veçanta brenda organizatës (s'ka rëndësi se sa i mirë është qëllimi pas tyre). Sektori kulturor është i dhënë pas përdorimit të fjalës strategjik; në fakt do të ishte e dobishme të mendohej për zgjidhje që janë *sistemo*. Përvetësimi i një të kuptuari dhe qasjeje sistemo do të ofronte një bazë të fortë për kryerjen e ndryshimeve domethënëse, të respektueshme dhe efektive në mënyrën se si funksionon organizata.

Muzeu është një sistem; secili ekip apo departament është një sistem. Muzeu funksionon *brenda* sistemeve dhe këto sistemeve përfshijnë shoqërinë e gjerë e cila (siç shpresoj se e kam treguar) në thelb është kundërshtuese, apo të paktën rezistente, ndaj barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Vizitorët me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi si dhe vizitorët e mundshëm, anëtarët e bordit dhe anëtarët e mundshëm të bordit, funksionojnë brenda këtyre sistemeve. Muzetë duhet t'i kuptojnë këto sisteme dhe ta vlerësojnë kufizimin e aftësive brenda tyre që të punojnë plotësisht me personat me aftësi të kufizuara dhe me mungesë dëgjimi.

Ka veçanërisht lidhje me gjërat praktike: marketingun; mënyrën se si hyjnë dhe si lëvizin njerëzit brenda një ndërtese, ekspozimet, ekspozitat dhe informacionin; si përshkruhen objektet, si interpretohen dhe janë vendosur në kuptimin fizik. Megjithatë, është shumë më tepër se kaq. Ka lidhje me mënyrën se si muzetë bindin personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi që janë vërtet të mirëpritur në ndërtesë apo në aktivitet; me bordin tuaj; me punën që është ekspozuar. Ka lidhje me mënyrën sesi personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi portretizohen në materialet e reklamimit. Ka lidhje me mënyrën se si është trajnuar stafi për të qenë i sigurt, i qetë dhe i shkathët përreth personave me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi. Ka lidhje me kulturën e punës dhe nëse ajo i përshtatet personave me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi apo jo. Shkurt, ka lidhje me sa janë muzetë të përgatitur të vënë në dyshim gjithë mënyrën sesi funksionojnë sistemet e asaj organizate.


Mendimi im është që, ndërsa 20 vjet më parë personat me aftësi të kufizuara ndodheshin jashtë duke parë *brenda*, tashmë gjendemi brenda duke parë *përreth*. Me fjalë të tjera, ne na lejohet shpesh të hyjmë në ndërtesa dhe aktivitete, por sapo arrijmë, nuk ka shumë gjëra në to ku mund të marrim pjesë, nuk ka shumë në trajtë objektësh, veprash arti apo interpretim ku e shohim veten dhe ka shumë pak në trajtën e aktiviteteve ku mund të marrim pjesë sipas kushteve tona - dhe të barabarta.

Nëse përqendrohemi vetëm tek të menduarit mbi aksesin, do të përfundojmë këtu në mënyrë të pashmangshme. Na duhet një ide më e madhe, një këndvështrim më i bazuar në sisteme për të menduar në lidhje me përfshirjen e vërtetë dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi.

Sigurisht që është e nevojshme të mendohet mbi aksesin. Nga perspektiva e modelit shoqëror, është shumë e rëndësishme të rishikoni mjediset tuaja dhe të vini në dukje pengesat. Pikënisje e mirë do të ishte të mendonit në lidhje me pengesat fizike, pengesat shqisore, pengesat intelektuale, pengesat e sjelljes dhe mund t'ju duhet (duhet) të flisni me personat me aftësi të kufizuara dhe

⁶ Neni 1

⁷ Neni 27



mungesë dëgjimi për t'u siguruar që i keni identifikuar gjithë problemet. Pastaj duhet të merreni me zgjidhjen e problemeve në mënyrë krijuese në mënyrë që të gjeni mënyra për t'i hequr këto pengesa. Aty ku ato janë të shtrenjta apo ku ju duhen burime të cilat nuk i keni, duhet t'i mendoni përsëri dhe të gjeni mënyra më të thjeshta e më të lira për të arritur të njëjtin rezultat. Për shembull, nëse nuk ka buxhet për instalim të dymave automatike, a mundeni të paktën të vendosni një zile në derë (në lartësi të përshtatshme!) në mënyrë që dikush, i cili nuk i hap dot dyert në mënyrë të pavarur, të paktën të lajmërojë stafin që është aty dhe ka nevojë për ndihmë? Nëse nuk mund ta riprojektoni banakun e shërbimit në bar, a mund të trajtoni stafin që të ofrojë shërbim të matur në tryezë?

Gjërat më të rëndësishme *sistmore* që mund të bëni në organizatën tuaj janë:

- të nxitni një program që përsëritet për Trajnimin mbi Barazinë e Aftësive të Kufizuara (të bazuar në modelin shoqëror të aftësive të kufizuara) për t'u siguruar që keni një ekip stafi 'të sigurt për aftësitë e kufizuara'
- të këshilloheni me personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi për t'u siguruar që po i plotësoni vërtet nevojat e tyre
- të futni praktika përfshirëse në politikat dhe praktikatat tuaja rreth planit dhe programimit të ekspozitës
- të planifikoni përmirësime të tjera me kalimin e kohës: askush nuk pret që t'i zgjidhni të gjitha problemet brenda natës
- të flisni me muze të tjera për të ndarë ide dhe burime
- Është paradoks: në aspekte tërësisht praktike, kjo nuk është e vështirë. Gjithçka që duhet janë tre faza të thjeshta:
- të identifikoni pengesën
- të kuptoni pse ajo përbën pengesë
- ta hiqni

Vështirësia që mund të haset nga muzeu i cili e merr këtë seriozisht, është se ai do ta shohë veten 'duke notuar kundër rrymës' ndërkohë që sfidojnë sisteme të tjerë, më të mëdhenj.

Muzetë, tregimi i historive dhe mbajtja e objekteve në mirëbesim për shoqërinë, mund të jetë faktor ndryshimi për personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi në shoqëri. Duhet të bëhet edhe shumë më tepër, por kontributi juaj mund të jetë thelbësor. Një qasje sistmore do të sigurojë që angazhimi me personat me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi shkon më tej, thjesht duke siguruar akses në atë që ofroni.


Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Modeli shoqëror i aftësive të
kufizuara

Modeli mjekësor i aftësive të kufizuara

Modeli Mjekësor përqendrohet tek
individit


Modeli mjekësor



Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara

Modeli Shoqëror përqendrohet tek mjedisi

Modeli shoqëror



Shkaqet e aftësive të kufizuara

Modeli mjekësor

p.sh.

Mungesë shikimi

Mungesë dëgjimi

Paralizë

Aksidente

Dhunë

Çrregullime gjenetike

Sëmundje

Modeli shoqëror

p.sh.

Shkallë

Gurë kalldrëmi

Dyer të rënda

Sjellja

Praktika punësimi

Kujdes i ulët për klientin

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara

Mjekësor	Shoqëror
Individi	Mjedisi
Çfarë problemi ke?	Çfarë pengesash ka këtu?
Informacion personal	Informacion praktik

Modeli shoqëror i aftësive të kufizuara

Kjo do të thotë të kërkojen *pengesat*

Dhe pastaj të kërkojen zgjidhje krijuese

Ai gjithashtu nënkupton

njohjen e pengesave si

- sjellja
- pritshmëritë
- stereotipet dhe hipotezat

Lajmi i mirë është që...

- Modeli Shoqëror fuqizon Muzetë tuaj
- Muzetë tuaj mund të sjellin ndryshim të mënyrës si shihen njerëzit me aftësi të kufizuara...
- ...dhe si e shohin veten

Identifikimi i pengesave dhe zgjidhjeve

Mendoni për muzeun tuaj. Çfarë pengesash keni ende që mund t'i ndalojnë njerëzit me aftësi të kufizuara ta vizitojnë?

Si mund të hiqen këto pengesa?

	Pengesat	Zgjidhjet
Ndërtesa juaj		
Marketingu		

	Pengesat	Zgjidhjet
Ekspozitat dhe ekspozimet		
Sjellja e stafit		

	Pengesat	Zgjidhjet
Politika / Kultura Organizative		
Të tjera		

LISTË E SHPEJTË KONTROLLI për mënyrën si po ecni në ofrimin e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara

Si ta përdorni këtë listë kontrolli

Përdorimi i kësaj liste kontrolli do t'ju pajisë me një vështrim të shpejtë mbi:

- gjërat që po bëni mirë;
- gjërat që duhet të përmirësoni;
- gjërat për të cilat as nuk keni menduar ende.

Mund t'i diskutoni rezultatet me kolegë të tjerë.

Lista e shpejtë e kontrollit do t'ju ndihmojë edhe në identifikimin e fushave ku doni të përqendroni përpjekjet për vlerësim më të detajuar.

(Ky dokument është përshtatur nga Muzetë, Arkivat dhe Bibliotekat, MB)

Ju, a:	Shënoni këtu nëse po e bëni mirë	Shënoni këtu nëse duhet ta përmirësoni	Shënoni këtu nëse nuk e keni menduar ende
1. Flisni me shumë njerëz me aftësi të kufizuara që t'ju ndihmojnë të përmirësoni muzeun?			
2. Krijoni aktivitete apo mundësi specifike në muze për njerëzit me aftësi të kufizuara?			
3. Mendoni se çfarë u ofroni vizitorëve në mënyrë që të nxitni njerëzit me aftësi të kufizuara ta vizitojnë muzeun?			
4. Krijoni mjedise që përdoren me lehtësi nga njerëzit me aftësi të kufizuara?			
5. Siguroheni që stafi është i aftë të ofrojë mbështetje për njerëzit me aftësi të kufizuara?			
6. Promovoni muzeun si një vend për njerëzit me aftësi të kufizuara?			
7. Vlerësoni shërbimet, programet dhe aktivitetet tuaja?			

Shkrimi i një Guide Aksesi

Mbani mend – shihni shembuj nga organizata të tjera.

Mbani mend - është shumë e rëndësishme dhënia e informacionit të saktë.

A. Të shkosh atje

A mund të shkojnë vizitorët lehtësisht me transport publik në muzeun tuaj?

A ka parking? A ka ndonjë pjesë të tij të rezervuar për njerëzit me aftësi të kufizuara?

A gjendet lehtësisht Muzeu dhe a gjendet lehtësisht hyrja kryesore?

A ka më tepër se një hyrje? Nëse po, a është e qartë se cila mund të jetë më e mire për t'u përdorur nga vizitorët me aftësi të kufizuara (për shembull, nëse ka shkallë në hyrjen kryesore, a keni hyrje tjetër pa shkallë)?

B. Hyrjet dhe dyert e brendshme

A ka shkallë, apo platformë të pjerrët, apo të niveluar?

A shënohen qartë shkallët dhe platformat e pjerrëta?

A kanë parrmakë shkallët dhe platformat e pjerrëta?

A janë dyert aq të gjera sa të hyjë dikush me karrige me rrota?

A janë dyert aq të lehta sa të hapen lehtësisht, apo janë automatike, a janë me rrëshqitje apo me kanatë?

Si është sipërfaqja e dyshemesë (për shembull, me pllaka me shkëlqim, apo tapet prej gome)?

A duhet të paguani për të hyrë në Muze? Nëse po, a u ofrohen njerëzve me aftësi të kufizuara çmime të përshtatura, dhe a keni nevojë që dikush t'ju dëshmojë se është me aftësi të kufizuara?

C. Lëvizja

Përshkruani korridoret (për shembull, a janë të gjerë, të ngushtë, të errët, të ndriçuar, zakonisht të populluar, zakonisht të qetë?).

A kanë të gjitha ambientet tuaja (për shembull, zonat e ekspozitave dhe hollet) hapësirë të mjaftueshme që një përdorues karrigeje me rrota apo dikush që përdor bastun apo paterica të lëvizë lirisht, përfshi edhe të rrotullohet?



Guida e aksesit duhet të përmbajë informacionin bazë si për shembull gjetjen e rrugës në ndërtesë

Përshkruani planin e ngjyrave (për shembull, a ka kontrast të mirë ngjyrash apo është e vështirë të dallohen muret nga dyshemet?).

A bën kontrast ngjyra e dyerve në mënyrë që të dallohen lehtë?

A luhet muzikë apo ndonjë tingull tjetër? Nëse po, a është e lartë, a do të ishit të gatshëm ta ulnit po t'ju kërkohet?

A ka shkallë? Nëse po, a janë shënuar qartë dhe a kanë parrakë?

A ka ashensorë? Nëse po, a janë dyert mjaftueshëm të gjera për të hyrë një përdorues karrigeje me rrota? A janë butonat aq poshtë sa t'i arrijnë njerëzit e shkurtër apo përdoruesit e karrigeve me rrota? A janë shënuar butonat me alfabet Braille? A është e qartë se cili kat është? A ka pasqyrë në murin e pasmë të ashensorit? A ka informacion me zë që u tregon përdoruesve në cilin kat gjenden dhe kur hapen e mbyllen dyert?

A ofrohen vende për t'u ulur përreth Muzeut?

D. Shenjat dhe informacioni

A gjendet lehtë informacioni?

A ofrohet informacion në formate të ndryshëm? (alfabet Braille, audio, gërma të mëdha?)

A shihen lehtë shenjat? A janë gërmat të mëdha sa duhet? A bëjnë kontrast të mirë ngjyrat me sfondin?

A janë përdorur figura veç fjalëve në tabela?

A është i lehtë orientimi nëpër muze me anë të shenjave?

A keni qarqe induksioni në muze? Nëse po, në cilat zona?

E. Zonat sociale dhe të recepsionit

A duket se këto zona popullohen, apo a janë të mëdha sa duhet për numrin e zakonshëm të njerëzve që i përdorin?

A është e lehtë të lëvizësh në këto zona dhe të shohësh nga duhet filluar vizita në muze?

Këto zona janë të errëta apo të ndriçuara?

A luhet muzikë apo ndonjë tingull tjetër? Nëse po, a janë me volum të lartë?

A kanë sipërfaqet e banakëve dhe sporteleve dy lartësi të ndryshme?

A mund të zhvendosen mobilet në bar?

A duket i ndjeshëm stafi ndaj nevojave të njerëzve dhe i gatshëm për të ndihmuar?

A është trajnuar stafi për barazi të njerëzve me aftësi të kufizuara?

Nëse keni bar, a ka informacion për kërkesat dietike të njerëzve?

F. Tualetet

A ka mjaft tualete?

A janë ata të aksesueshëm?

A sinjalizohen mirë me tabela dhe a është hyrja në ta e lehtë?

A janë të pastër e të pajisur mirë?

A ka ambiente për të ndërruar bebet? Po në tualetet e aksesueshëm?

A mbahen tualetet të rregullt?

G. Galeritë dhe ekspozitat

A janë ndërtuar ekspozitat në mënyrë që gjithçka të shihet lehtë? A mundet një njeri i shkurtër apo dikush në karrige me rrota të shohë të gjitha ekspozimet?

A ka ekspozime që mund të preken?

A janë etiketat në formate të ndryshëm? A janë të mëdha sa duhet dhe të vendosura aty ku mund t'i lexojnë shumica e njerëzve? A janë shkruar në gjuhë që kuptohet lehtë?

A është e qartë nëse ka një rrugë të preferuar përreth ekspozitës?

A ka katalog? Nëse po, a ofrohet në formate të ndryshëm?

A ofrohen vizita me audio?

A ka aktivitete me interpretim në Gjuhën e Shenjave?

H. Të përgjithshme

Sa kohë zgjat një udhëtim në këtë Muze?

Pse do të dëshironte një person me aftësi të kufizuara ta vizitonte atë?

A ka muze të tjerë në afërsi që vizitorëve mund t'ju duken interesante?

A është i mirë ky muze për të sjellë fëmijë?

Paraqitja e një propozimi

Mund t'ju duhet që të paraqitni një propozim për të bindur njerëzit të financojnë një projekt ose program pune me njerëzit me aftësi të kufizuara. Kjo mund të nënkuptojë prezantimin për të marrë mbështetje financiare në një audiencë të jashtme apo tek njerëzit e organizatës suaj.

Prezantimi juaj duhet ta bindë audiencën që është një projekt i mirë dhe që të investojnë në të.

Duhet ta njihni audiencën – cilat janë prioritetet e tyre, dhe cilat punë ka më shumë gjasa të mbështesin.

Sigurohuni që përfshini elementët e mëposhtëm:

1. synimet tuaja kryesore për projektin (dhe përfshini si përshtatet projekti me synimin dhe karakterin e përgjithshëm të muzeut)
2. objektivat (ato detyrat më të vogla, të matshme që do të kontribuojnë që realizimin e synimeve)
3. grupin që synon projekti
4. detaje mbi aktivitetin (çfarë do të ndodhë, ku, kur dhe për sa kohë)
5. cilët anëtarë të stafit do të përfshihen në secilën fazë
6. detaje se si do të vlerësohet projekti, përfshi gjërat të cilat nuk i prisnit
7. planin kohor (çfarë do të planifikoni, ofroni dhe rishikoni)
8. burimet që ju nevojiten (njerëz, kohë, para, kërkime, gjëra të tjera)
9. çfarë e vendos suksesin e projektit në rrezik dhe shmangien e tyre
10. jini pasionantë, bëni që audiencia të ndajë entuziazmin tuaj
11. a është bërë kjo në vend tjetër, dhe nëse po, çfarë mësimesh mund të nxirren?
12. si do ta ndani atë që mësuat nga ky projekt me muze të tjerë?
13. pse duhet ta mbështesin ata këtë projekt, cilat janë përfitimet më të gjera?



Nëse dëshironi financim për një projekt, duhet të jeni të aftë të bindni njerëzit që kanë paratë se ai ia vlen

Shkrimi i një raporti vlerësues

1. Hyrje

Një përmbledhje e projektit tuaj dhe hyrje në gjërat që keni mësuar

2. Çfarë bëtë?

Cilat ishin synimet dhe objektivat tuaja? (Këto duhet të gjenden në formularin tuaj origjinal të aplikimit)

Si shkoi planifikimi, ofrimi dhe rishikimi i projektit?

Çfarë ndodhi në të vërtetë, kur, ku dhe kush u përfshi (stafi, ekspertët e tjerë dhe pjesëmarrësit)?

Çfarë partneriteti krijuat? (Me kë punuat, në veçanti njerëzit me aftësi të kufizuara?)

3. Çfarë mësuat?

A i realizuat objektivat tuaja?

Nëse po, si dhe pse dhe nga e dini?

Nëse jo, si dhe pse dhe nga e dini?

Çfarë mësimesh nxorët?

Çfarë (nëse mundeni) do të bëni ndryshe herën tjetër?

4. Ndikime të tjera

Ndikim do të thotë gjërat që kanë ndodhur si rezultat i projektit apo ndryshimit që sollti projekti; për shembull, tek njerëzit me aftësi të kufizuara, tek vizitorët e tjerë, tek stafi apo tek muzeu në tërësi.

A ndodhi gjë si rezultat i projektit të cilën nuk e keni përshkruar ende? Për shembull, a ka pasur në përgjithësi më shumë vizitorë në muze? Apo vizitorët kanë komentuar se u pëlqejnë ndryshimet që keni bërë? Ose ndoshta stafi i cili nuk ka qenë i përfshirë drejtpërsëdrejti me projektin ka treguar interes për të punuar me aftësitë e kufizuara.

Çfarë ndikimi pati projekti tek pjesëmarrësit dhe nga e dini?

A pati ndikim projekti në muze si organizatë në tërësi? Nga e dini?



Për çdo ekspozitë, projekt, seminar apo ide të re, duhet të zbuloni nëse funksionoi. Për shembull, a u duken njerëzve të dobishme këto stola dhe, nëse jo, çfarë mund të bëni për të rritur dobinë e tyre? Vlerësimi lidhet me mësimet që nxirren në mënyrë që në të ardhmen të planifikoni më mirë



5. Buxheti

Përfshini një përmbledhje të buxhetit të projektit.

Shpjegoni çdo ndryshim nga buxheti origjinal.

A shkoi sipas planifikimit?

Nëse jo, pse?

6. Konkluzione

Përmbliidhni atë që mësuat dhe çfarë mund të bëni në vijim për të zhvilluar punën e muzeut me njerëzit me aftësi të kufizuara.

Diskutoni mbi mënyrat si mund të përdoren mësimet tuaja nga të tjerët.

Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Aplikimi për Fonde

Organizata juaj

Financuesit kërkojnë të dinë:

- Madhësinë e organizatës
- Sa staf ka
- Me sa para jeni mësuar të punoni?

Kjo lidhet me atë që në anglisht, quhet **kapacitet**

A besoni se mund ta zbatoni projektin?

Projekti (1)

Ata kërkojnë të dinë:

- Projekti me pak fjalë
- Nëse ju e keni të qartë atë që doni të realizoni (synimet)
- Nëse ju i keni të qartë hapat që duhet të ndërmerrni për t'i realizuar (objektivat)
- Nëse po ndodh në kohën e duhur
- Nëse objektivat janë INTELIGJENTË

Kjo lidhet me **qartësinë**

Projekti (2)

Ata kërkojnë të dinë:

- Sa i rëndësishëm është ky projekt në muzeun tuaj
- Nëse do t'ju ndihmojnë njerëz të tjerë
- Nëse dhe si do të luajnë rol aktiv në projekt njerëzit me aftësi të kufizuara

Vlerësimi i projektit

Ata kërkojnë të dinë:

- Si do të jeni në gjendje të tregoni që paratë e tyre u shpenzuan siç duhet
- Si do të nxirrni mësim nga projekti

Kjo lidhet me vlerën e projektit

Mbështetja

Ata kërkojnë të dinë:

- Sa keni menduar për nevojat e tyre
- Si do të ketë muzeu përfitim afatgjatë nga paratë e tyre

Kostot

Ata kërkojnë të dinë:

- Sa realistë jeni në lidhje me koston e projektit
- Si lidhet kjo me shpenzimet e përgjithshme
- Nëse paratë e tyre po përdoren në mënyrë efektive

Deklarimi

Ata kërkojnë të dinë për:

- Mbështetjen nga dikush me pozicion të lartë në muze

Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Politika dhe planifikimi
ose Të Dini Çfarë Po Bëni
dhe Përse Po e Bëni

Çfarë është politika?

- Deklarimi i cilësisë dhe përkushtimit ndaj publikut
- Deklarata e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë
- Të treguarit e SI funksionon në praktikë misioni i muzeut
- Të treguarit e SI do të shpërndahen dhe përdoren burimet për të arritur synime të caktuara


Vendi i politikës

“Nëse misioni nuk kuptohet plotësisht, politikat mbeten një formular bosh. Sidoqoftë, kur ato mbështesin një mision të miratuar, politikat mund të drejtohen në mënyrë më efektive drejt një qëllimi të përbashkët”

(Burimi: *Manuali i Menaxhimit të Muzeut*, Lord & Lord, HMSO 2000, fq7)

Misioni dhe Politikat

(Lord & Lord 2000)



Komponentët kryesorë

- Deklarim i synimeve
- Deklarim i funksioneve
- Niveli i cilësisë
- Standarde realiste
- Lidhja me të tashmen DHE të ardhmen

- Ajo duhet të jetë e kuptueshme

Kujt i drejtohet?

- Drejtuesve
- Administratorëve
- Bordeve
- Stafit
- Publikut
- Grupeve të tjerë të interesit (financuesve, shtypit, etj)

Zhvillimi i politikës

- Cilët janë grupet tuaj të interesit?
- Me kë duhet të këshillohemi?
- Kush duhet ta shkruajë?

Analiza



Sjellja në jetë

- Monitorimi
 - Kush mund ta monitorojë?
 - Sa shpesh duhet të bëhet
- Rishikimi
 - Kur duhet të përditësohet?

Planifikimi për barazi të aftësive të kufizuara

Spektori i punës	Për 1 muaj	Për 6 muaj	Për çfarë kam nevojë
Ndërtesa			
Ekspozita			
Informacioni			
Stafi			
Edukimi			

Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Përgatitja një Guide Aksesi

Çfarë është një guidë aksesi?

- Është një dokument i cili u jep njerëzve me aftësi të kufizuara dhe mungesë dëgjimi informacion të rëndësishëm për sa i përket vizitës në muzeun tuaj dhe shijimit të saj si gjithë të tjerët
- Kjo nënkupton se duhet të përfshini kufizimet që mbeten ashtu si edhe gjërat që keni bërë për të hequr pengesat

Çfarë duhet të përfshi?

Ky është një vendim që duhet ta merrni ju.

Disa muze përfshijnë një sasi të madhe informacioni ndërsa disa të tjerë e japin në nivelin bazë.

Sido që të jetë, sigurohuni që njerëzit dinë si të marrin informacion të mëtejshëm - dhe që njerëzit që mbushin 'telefonat dhe emailin sqarohen siç duhet; nuk mund të parashikoni nevojat e të gjithëve për informacion prandaj duhet të reagoni shpejt

Mendoni në mënyrë krijuese

Një nga shembujt tanë të preferuar është ai i muzeut Ironbridge.

Ai tregon se sa kohë mund të dëshironi të shpenzoni në secilin muze - ky është një informacion shumë i dobishëm pasi u lejon njerëzve të vendosin sa mund të rezistojë niveli i energjisë së tyre.

Përdorni imagjinatën, çfarë do të dëshironit *ju* të dinit (dhe përgatituni që gjithë vizitorëve t'u duket Guida juaj e Aksesit e dobishme!)

Mbani mend

- Figurat janë veçanërisht të dobishme
- Nëse dhe kur të keni një faqe interneti, përfshini në të Guidën e Aksesit, dhe bëjeni të shkarkueshme
- Guida duhet të përmbajë "të mirin, të keqin dhe të shëmtuarin"!

Udhëzime Për Përfshirjen Dhe Këshillimin Me Njerëzit Me Aftësi Të Kufizuara

1. Filloni me 'një copë letër bosh' dhe lëroni njerëzit me aftësi të kufizuara t'ju tregojnë se çfarë është e rëndësishme

Jini të hapur dhe të ndershëm për gjërat të cilat nuk mund të bëhen dhe për mënyrën se si do t'i përdorni komentet (a do të trajtohen ata si sugjerime, rekomandime apo si gjëra që duhen bërë patjetër?)

2. Kuptoni pikënisjen tuaj dhe vendosni objektiva dhe plane kohorë realistë

Diskutoni për çfarë kanë nevojë njerëzit me aftësi të kufizuara me të cilët po këshilloheni në mënyrë që të jenë të dobishme për ju, për shembull për trajnime apo mundësi të tjera të mësuari.

3. Krijoni mbështetje të gjerë brenda organizatës për përdoruesit këshillues

Kjo mund të rrisë vlerën e parave dhe të ndihmojë stafin të kuptojë përse po e bëni.

4. Identifikoni dhe ndërtoni marrëdhënie që herët me përdoruesin 'kampion'

Përdoruesit 'kampionë' janë njerëz me aftësi të kufizuara që e kuptojnë çfarë doni të bëni në muze, besojnë se është e rëndësishme dhe kanë ndikim lokal tek njerëzit me aftësi të kufizuara. Ata kanë rol të rëndësishëm për t'ju treguar vështirësitë dhe për të motivuar të tjerët të marrin pjesë.

5. Hartoni një profil të përdoruesve dhe përdoruesve të mundshëm

Përdorni mënyra të ndryshme për t'u siguruar që merrni pikëpamje të shumta.

6. Mos u bazoni në komunikimin me letër

Për shumë njerëz me aftësi të kufizuara, kjo nuk është e dobishme. Mund t'ju duhet të dërgoni emaile, të shpenzoni kohë në telefon ose madje edhe të takoheni me njerëzit ballë për ballë.

7. Përfshini përdoruesit në shkrimin e pyetjeve

Pyetësorët dhe sondazhet mund t'i largojnë njerëzit që në fillim nëse nuk kanë pyetjet e duhura, prandaj këshillohuni përpara se të shkruani gjë.



Sigurohuni që përmbushni kërkesat e njerëzve për akses, për shembull duke prenotuar interpretë të Gjuhës së Shenjave

*Përshtatur nga Muzetë,
Arkivat dhe Bibliotekat (MB)*



8. Merrni në konsideratë intervistat dhe diskutimet e hapura me përdoruesit

Kjo mund të rezultojnë në komente më të ndershme dhe transparente.

9. Takohuni me përdoruesit në një kohë dhe vend që u përshtatet atyre

Në këtë mënyrë, do të siguroheni që po respektoni kërkesat e tyre të aksesit.

10. Mos prisni që përdoruesit të sillen si staf që paguhet

Sidoqoftë, ata duhet të paguhen për kontributin e tyre në çfarëdo lloj mënyre që të mundeni. Duhet të paguani shpenzimet dhe mund të merrni në konsideratë një tarifë.

11. Vendosini prioritetet bazuar në atë që ka rëndësi për shumicën e përdoruesve.

12. Jepni rregullisht komente përdoruesve

Tregoni për çfarë ju thanë e çfarë do të ndryshoni ju si rezultat i saj.

Partneritetet – faktorët e suksesit

Gjatë punës sonë, kemi vënë re se disa aspekte të punës me partnerët duhet të jenë siç duhet që partneriteti të jetë i efektshëm.

1. Organizatat partnere duhet të jenë të barabarta në partneritet
2. Çdokush në organizatat partnere duhet të kuptojë përfitimet e partneritetit; nëse ai mbështetet nga vetëm një ose dy njerëz në organizatë, do të jetë e vështirë që ajo organizatë të përfshihet plotësisht.
3. Të gjitha organizatat partnere duhet të miratojnë synimet dhe objektivat dhe të thonë se u përkushtohen atyre.
4. Të gjitha organizatat partnere duhet të jenë realiste në lidhje me sa kohë e burime të tjera kanë nevojë, dhe të provojnë se mund ta japin atë kohë e burimet e tjera
5. Idealisht, të gjitha organizatat partnere duhet të kuptojnë se mund t'ju duhet të ndryshojnë kulturën e organizatës së tyre që puna të jetë e suksesshme
6. Duhet të ketë komunikim të mirë, të qartë midis partnerëve, ndoshta midis individëve të caktuar nga çdo organizatë; kjo ndihmon për ta pasur më të thjeshtë.
7. Të gjithë partnerët duhet të kenë pritshmëri realiste mbi atë çfarë do të arrijë puna.

A ju kujtohen të tjera nga përvoja juaj?



Një nga përparësitë e partneritetit është se mund të jenë në gjendje të ndani burimet e një organizate më të madhe

Projektet e aftësive të kufizuara Niarchos

Këshillimi me njerëz që kanë
mungesë dëgjimi dhe aftësi të
kufizuara

Sipas një sondazhi, bibliotekat, muzetë dhe arkivat që ishin "performues të lartë" (të cilat përmbushnin të paktën 85 nga 125 tregues) kishin rreth:

- 50% më shumë mundësi për të kryer këshillim jozyrtar me përdoruesit sesa "performuesit e ulët"
- 4 herë më shumë mundësi për të organizuar aktivitete të projektuara për të lejuar komente nga njerëzit
- 4 herë më shumë mundësi për t'u këshilluar me grupet e përdoruesve
- 10 herë më shumë mundësi për të ofruar shërbime të reja me përdorues dhe jo-përdorues
- 10 herë më shumë mundësi për t'u këshilluar me grupet e jo-përdoruesve

Partneriteti

- Këshillimi duhet të bazohet më shumë në një qasje partnerësh se sa në një qasje ofruesi.
- Në këtë mënyrë, njerëzit do të kenë ndjesinë e pronësisë dhe ka më tepër të ngjarë që të përfshihen

Për t'u marrë në konsideratë...

- Duhet të menaxhoni pritshmëritë
- Duhet të paguani shpenzimet e njerëzve
- Mund të jetë e përshtatshme që njerëzit të paguhen për kohën e tyre
- Identifikoni portierët
- Çfarë lloj modeli do t'i përshtatej më mirë Muzeut tuaj?
- Kuptojeni aksesin siç duhet!!

Krijimi i partneritetit lokal me njerëzit me aftësi të kufizuara

Ivan Krucican, Muzeu Kombëtar i Serbisë, Beograd

Duke u përpjekur të krijojmë një qasje përfshirëse dhe të organizojmë ekspozita dhe aktivitete të tjera në Muzeun Kombëtar në Beograd, na u desh të kontrollojmë nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të planifikojmë si mund t'i përmbushim këto nevoja.

Në fillim çdo gjë ishte e drejtpërdrejtë, sepse njerëz nga organizata të ndryshme të njerëzve me aftësi të kufizuara dëshiruan të ndihmonin dhe u entuziazuan nga kjo ide. Shumë shpejt zbuluam se ata nuk kishin përvojë dhe nuk e dinin me saktësi se çfarë duhej të kërkonin. Kjo vinte kryesisht për shkak të mungesës së aksesit në ofertën kulturore (përveç koncerteve në disa salla koncertesh në Beograd). Kështu që, mënyra më e logjishme e të menduarit ishte të përpiqeshim t'i bënim ekspozitat dhe aktivitetet e rregullta të muzeut të disponueshme për një audiencë më të gjerë. Por atëherë, u përballëm me probleme të tjera, për shembull, që shumica e galerive tona ishin ose të paaksesueshme nga përdoruesit e karrigeve me rrota, ose që prekja ishte e ndaluar ose që nuk kishte shpjegime të mjaftueshme..

Fatkeqësisht, edhe pse punojmë me organizata të njerëzve me aftësi të kufizuara, fillimisht nisëm të përdornim qasjen mjekësore, madje as pa e ditur se çfarë ishte. Gabimi i fillestarit na ndihmoi të mësonim shumë. Pranuam problemin e zakonshëm, jo vetëm në Beograd apo Serbi, por gjithashtu kudo tjetër në rajon: që duhet të përdorim një kuptim të ndryshëm të asaj për të cilën kanë nevojë dhe presin njerëzit me aftësi të kufizuara. Shumica e organizatave përdorte terminologji të ndryshme, por problemi nuk ishte thjesht tek përdorimi i gjuhës, por në qasjet dhe mënyrat krejtësisht të ndryshme të të kuptuarit të problemeve dhe kërkimit të zgjidhjeve të mundshme.

Në këtë pikë ishte shumë i dobishëm udhëzimi i ekspertëve të CHwB-së, sepse ata na ndihmuan të pranohim gabimet tona dhe na udhëhoqën drejt një përdorimi më të dobishëm të fjalëve si edhe drejt qasjeve dhe mënyrave për të zgjidhur problemet.

Bashkëpunimi me njerëzit me aftësi të kufizuara u përmirësua shumë pasi kryem serinë e seminareve dhe të programeve të CHwB-së.

Ne u nisëm nga potenciali dhe burimet tona për të krijuar partneritet. Rezultoi se të dyja palët kishin shumë për të ofruar dhe që po ndihmonim njëri-tjetrin për të gjetur modele më të mirë për të ardhmen. Kështu që, nga hapat e parë modestë drejt përfshirjes, deri më sot, kur jemi duke punuar së bashku me disa organizata mbi projekte të ndryshme, kishte disa faza.

Në fillim po përpiqeshim thjesht të bënim të aksesueshme disa ekspozita dhe të përmirësonim aksesin fizik. Më vonë, filluam të mendonim më tepër mbi mungesën e formimit artistik tek njerëzit me aftësi të kufizuara dhe filluam të punojmë së bashku me organizatat e tyre për formimin dhe shpjegimin e temave dhe lëvizjeve më të rëndësishme që kishin interes për ta.

Pas kësaj, filluam të përdornim burimet e organizatave të njerëzve me aftësi të kufizuara për të informuar më shumë prej tyre në lidhje me aktivitetet ku mund të marrin pjesë.

Pas disa ekspozitave përfshirëse, ia dolëm të nxitnim më shumë individë të na vizitonin, por edhe që të ruanim punën e mirë me organizatat dhe grupet.

Tani, jemi duke realizuar disa projekte. Biblioteka e Shoqatës së të Verbërve nuk ishte e plotë dhe ne duam të mbushim mangësitë që kanë në tekste mbi artin dhe kulturën. Përmes bashkëpunimit shumë të mirë me disa organizata të tjera (Shoqata Serbe për të Paralizuarit Cerebralë, Distrofia Muskulore, Shoqata e Njerëzve që kanë Mungesë Dëgjimi dhe të tjera), po nisim një projekt më të gjerë me mbështetjen e disa institucioneve të tjerë kulturorë. Ndërkohë që strategjia shtetërore do të përmirësojë aksesin, kryesisht përsa i përket kuadrit ligjor, organizatat e njerëzve me aftësi të kufizuara kanë zbuluar se ekzistojnë disa institucione kulturore të cilat e kanë përmirësuar aksesin ndërkohë dhe që të tjera po hedhin hapat e parë drejt përfshirjes. Në mënyrë që të shmangen gabimet fillestare, me kemi vendosur të hartojmë dhe të botojmë një libër udhëzimi për përfshirjen, me disa shpjegime teorike, por kryesisht me raste studimorë dhe shembuj praktikë të praktikave të mira dhe të këqija dhe të mënyrës se si janë bërë deri tani gjërat këtu. Platforma për këtë projekt nuk është përcaktuar ende plotësisht, por do të përfshijë partneritet me rreth 10 institucione (shtetërore dhe OJQ).

Partneriteti me Shoqatën e të Verbërve, e cila ishte shumë pozitive, u përmirësua edhe më tej së fundmi, sepse na u dha leje të përdorim studion e tyre të regjistrimit për prodhimin e dosjeve audio për bibliotekën e të verbërve.

Projekti ynë i fundit është gjithashtu rezultati i partneritetit të mirë me Shoqatën e Njerëzve që kanë Mungesë Dëgjimi. Parlamenti ynë do të votojë vitin e ardhshëm ligjin e ri që do të përmirësojë trajtimin e njerëzve me mungesë dëgjimi dhe të gjuhës së shenjave. Përkthyesit në institucionet publike do të jenë të detyrueshëm, por organizata e njerëzve që kanë mungesë dëgjimi nuk ka interpretë të mjaftueshëm. Edhe nëse do t'i kishin pasur, pagesa e tyre për çdo aktivitete do të kishte qenë problem, pasi po shkurtohen buxhetet e të gjitha institucioneve publike. Ekziston një ide për të organizuar trajnim dhe mësim të gjuhës së shenjave për punonjësit e institucioneve publike dhe pas kësaj, të vazhdojë puna me Shoqatën e Njerëzve që kanë Mungesë Dëgjimi mbi projekte të ndryshme ku mund të praktikohen dhe të përmirësohen.

Tashmë kemi mjaft përvojë për të shmangur gabimet e para. Në fillim, u mbështetëm të gjithë tek entuziazmi dhe sa here që kishim një projekt, sukcesi i tij varej nga një palë e tretë, dhe jo nga Muzeu apo organizatat partnere, mund të ndodhte që diçka të mos shkonte siç duhej ose të ishim përherë me vonesë. Tani kemi një qasje më realiste ndaj synimeve tona dhe nëse përfshihen dy apo më shumë partnerë, vendosim afate me elastike.

Shembuj – Informacion i mëtejshëm

Kjo është një listë e dokumenteve që keni në paketën udhëzuese, me detaje nga vijnë ato dhe disa faqe të tjera interneti ku mund të shihni për më shumë shembuj. Të gjitha dokumentet janë përdorur me leje.

Titulli i dokumentit	Prodhuar nga
Guida e Aksesit të Muzeut Detar Australian	I përdorur me leje të Muzeut Detar Australian
Informacion mbi Aksesin i Muzeut Britanik	I përdorur me leje të Muzeut Britanik
Informacion mbi Aksesin i Muzeut Discovery	I përdorur me leje të Shërbimeve dhe Muzeve Tyne and Wear
Guida e Aksesit të Muzeut Hertford	I përdorur me leje të Muzeut Hertford
Informacion mbi Aksesin i Muzeut të Historisë së Natyrës, Londër	I përdorur me leje të Muzeut të Historisë së Natyrës

Informacione të tjera	Mund të gjenden në
Informacion mbi Aksesin për Vizitorët i Muzeut Fitzwilliam	http://www.fitzmuseum.cam.ac.uk/visit/access/
Udhëzime për Projektim Ekspozitash të Aksesueshme, Instituti Smithsonian	http://www.si.edu/Accessibility/SGAED
Guidë Aksesi për në Muzeun e Grykës Ironbridge	http://www.ironbridge.org.uk/assets/Uploads/accessguide.pdf
Guidë Aksesi e Muzeut Mbretëror të Regjimentit Norfolk	http://www.rnrm.org.uk/html/a_guide.html

Guidë aksesi



Interpretja e Gjuhës Australiane të Shenjave Chevoy Brown përkthen gjatë një vizite të riprodhimit të HMB Endeavour

Muzeu synon të ofrojë akses maksimal në ekspozitat dhe ambientet e tij. Nëse keni pyetje apo komente mbi aksesin, lutemi telefononi në +61 2 9298 3777. Për prenotime në grup, lutemi telefononi punonjës in tonë të prenotimeve në +61 29298 3655.

Zbuloni se si të [shkoni në muze](#).

Nëse po sillni fëmijë për vizitë, mund të gjeni gjithçka që duhet të dini në [Guidën tone të mbijetesës së prindërve](#).

Parkim i aksesueshëm

Jashtë hyrjes kryesore të muzeut gjenden dy hapësira parkimi të dedikuara. Për të prenotuar parkimin paraprakisht, lutemi telefononi në +61 2 9298 3777.

Lëvizja përreth muzeut

Ka akses me platformë të pjerrët për në ndërtesën kryesore të muzeut nga hyrja kryesore. Ka akses me ashensor ose me platformë të pjerrët në të gjitha hapësirat e ekspozitave, dhe në skelat e platformën për suditje jashtë muzeut. Ka akses të kufizuar tek anijet. Për më shumë informacion, lutemi telefononi në +61 2 9298 3777.

Ofrohen karrige kortezie me rrota për të cilat nevojitet një depozitim i kthyeshëm dhe një dokument identiteti me fotografi. Për të prenotuar karrigen me rrota paraprakisht, lutemi telefononi në +61 2 9298 3777.

Tualetet e aksesueshme gjenden në katin e poshtëm të muzeut (i aksesueshëm me ashensor dhe vendkalim) si dhe në katin përdhe të hollit të hyrjes.

Shërbimet dhe programet për shikim dhe dëgjim të kufizuar

- Në teatër, në zonat kryesore të biletave dhe në sallat e takimeve të muzeut ofrohen qarqe induksioni audio. Lutemi telefononi në +61 2 9298 3777 për më shumë informacion. Në të gjithë muzeun ka ekrane interaktive.

- Muzeu ka programe me interpretim në Gjuhën Australiane të Shenjave për komunitetin e njerëzve me mungesë dëgjimi dhe programe të tilla si vizita përshkruese për vizitorët me shikim të kufizuar. Lutemi telefononi në +61 2 9298 3777 për më shumë informacion.
- Flags Ahoy! është një ekspozim i përvitshëm në Muzeun Kombëtar Detar të Australisë, Darling Harbour Sydney NSW, që mbahet në Ditën Ndërkombëtare të Njerëzve me Aftësi të Kufizuara. Programi është projektuar dhe zhvillohet në partneritet me grupet dhe komunitetet e njerëzve me aftësi të kufizuara nga i gjithë New South Wales.

Informacion mbi kujdestarët

Kujdestarëve u ofrohet hyrje falas në anijet tona. Lutemi paraqitni kartën tuaj të kujdestarit ose të shoqëruesit kur blini biletat.

Aksesi në faqen tone të internetit

Ndryshimi i madhësisë së tekstit

Për të ndryshuar madhësinë e tekstit të faqes sonë të internetit në Internet Explorer, klikoni mbi "View" tek menyja në krye të faqes, zgjidhni "Tekst Size" dhe përshtateni sipas dëshirës. Për informacion rreth ndryshimit të madhësisë së tekstit në shfletues të tjerë, si Firefox, Netscape, Opera dhe Safari, vizitoni faqen e internetit për aksesueshmërinë në rrjet W3C.

Në kompjuterin tuaj

Mund të bëni ndryshime të tjera për akses më të mirë të kompjuterit, si:

të zmadhoni ekranin

ta bëni shigjetën e mouse-it më të lehtë për t'u parë ndërroni ngjyrën

të aktivizoni 'folësin' e kompjuterit, një funksionin që kthen tekstin në zë.

Për të bërë këto ndryshime duke përdorur mjetet e Aksesueshmërisë së ofruar nga Windows, shkoni në Start > All programs > Accessories dhe zgjidhni Accessibility.

<http://www.anmm.gov.au/site/page.cfm?u=1345>

Aksesi



Hyrjet e muzeut

Hyrja e Great Russell Street entrance ka 12 shkallë me parmak.

Në të dy krahët e shkallëve ka ashensorë që mund të vetë-përdoren.

Në hyrjen e Montague Place ka akses të niveluar.

Për informacion: +44 (0)20 7323 8299




Marrja hua e një karrigeje me rrota

Ofrohen karrige me rrota për t'u marrë hua për vizitën në të dyja hyrjet.

Fatkeqësisht, Muzeu nuk mund të ofrojë ndihmë rreth Muzeut për përdoruesit e karrigeve me rrota.

Biletat e shoqëruesve për të gjitha ekspozitat dhe aktivitetet janë falas.



Ashensorët dhe aksesit në galeri

Shumica e galerive dhe të gjitha ekspozitave të veçanta janë tërësisht të aksesueshme.

Ofrohen plane të Muzeut falas në Oborrin e Madh, të cilët tregojnë vendndodhjen e ashensorëve.

[Shih në planin e kateve vendndodhjen e ashensorëve dhe të galerive](#)



Qentë guidë dhe ndihmës

Qentë guidë dhe ndihmës janë të mirëpritur. Disponohen tasa për qentë.

Pyetni tek Sporteli i Informacionit në Oborrin e Madh.



Parkimi për njerëzit me aftësi të kufizuara

Ofrohet një numër i kufizuar vendesh parkimi për njerëzit me aftësi të kufizuara që vizitojnë Muzeun.

Lutemi telefononi në +44 (0)20 7323 8299 të paktën 24 orë më përpara.

Duhet të jepni detajet e targës, prodhimit dhe modelit të mjetit si dhe datën e vizitës.



Vendet për t'u ulur

Në Oborrin e Madh ka stola dhe karrige.

Në galeri të veçanta ofrohen vende për t'u ulur.

Pyetni tek Sporteli i Informacionit në Oborrin e Madh.

Lutemi telefononi paraprakisht në +44 (0)20 7323 8299



Sistemi i përmirësimit të tingullit / Qarqet e induksionit

Qarqet e induksionit funksionojnë në Qendrën Clore dhe në Sportelin e Informacionit.

Disponohet sistem i përmirësimit të tingullit me qarqe induksioni për shumicën e përshkrimeve në galeri dhe vizitat eyeOpener.



Guidat multimedia

Mbi 200 përshkrime audio të Muzeut i theksojnë objektet me hartë interaktive të galerive.

Sponsorizuar nga Korean Air

[Prenoto online](#)

[Guidë Multimedia BSL](#)

[Guidë Multimedia për fëmijë](#)

Pyetni në Sportelin e Guidës Multimedia



Gjuha Britanike e Shenjave (BSL)

Njëherë në muaj janë planifikuar biseda në galeri në Gjuhën e Shenjave.

[Shih kalendarin e aktiviteteve](#)

[Guidë Multimedia e 200 objekteve që disponohen](#)

[Përkthimi në BSL i 18 objekteve të theksuara](#)



Sigurimi i aksesit për grupet

- Vizita të shoqëruara nga një vullnetar i Muzeut
 - Seanca prekjeje të përshtatura rreth një fushe me interes të grupit për njerëzit me aftësi të kufizuara që studiojnë
 - Diskutime mbi koleksionin të përshtatura me interpretim shenjash që u drejtohen fushave me interes të grupit
- Nëse një anëtar aspo disa anëtarë të grupit kërkojnë t'ju sigurohet akses, lutemi kontaktoni Jane Samuels, Menaxher i Aksesit, të paktën gjashtë javë përpara vizitës suaj, në +44 (0)20 7323 8506 ose jsamuels@britishmuseum.org

[Shkarko Skemën e Barazisë për dhe planin e Veprimit për Aftësitë e Kufizuara](#)



Seancat me prekje

Muzeu ka seanca ditore me prekje në galeri të veçanta. [galeritë e veçanta](#)

Vizitat me prekje

Ofronet vizitë me prekje për [Galerinë e Skulpturave Egjiptiane \(Dhoma 4\)](#) dhe për [Skulpturat e Partenonit \(Dhoma 18\)](#), të cilat kanë etiketa në alfabet Braille dhe skulptura të Partenonit me relief allçie.

Informacion mbi aksesin në Muzeun Discovery

Hyrja

Rruga nga parkingu i makinave tek porta kryesore është e shtruar me asfalt. Tek porta kryesore ka një të tatëpjetë të butë drejt hyrjes. Dyert rrëshqitëse automatike çojnë në hyrjen kryesore në të cilën mbizotëron 'Turbinia', anija e parë me avull. Gjithashtu këtu mund gjendet edhe Sporteli i Informacionit dhe pjesa me dyqane.

Lëvizja përreth muzeut

Brenda Muzeut ka ashensorë dhe shkallë që sigurojnë akses në të gjitha katet. Të gjithë ashensorët kanë lajmërim me zë dhe tregues në alfabetin Braille. Shtrirja e Muzeut përfshin katin nëntokësor, katin përdhe dhe katet e dytë dhe të tretë me akses në katin e katërt kur ka ekspozita në Hollin e Madh. Bari gjendet në katin e dytë.

Mund të shkohet në të gjitha katet, që nga platforma e pjerrët e katit nëntokësor deri tek kati përdhe në hyrjen kryesore. Shkallët kanë tregues me prekje në parmakë. Galeria e Historisë së Newcastle e ka dyshtemenë pjesërisht të ngritur për lehtësi lëvizjeje.

Po prodhohen harta të mëdha statike vizuale apo me prekje për t'ju ndihmuar të orientoheni në çdo kat të Muzeut.

Vendet për t'u ulur

Në hyrjen kryesore ka karrige me mbështetëse për krahët. Në Galerinë e Jetëve Punëtore dhe Sfidës Tyneside në katin e parë ka një stol për t'u ulur. Ka ndenjëse me krahë dhe stol edhe në Galerinë e Jetës së Ushtarit. Galeritë Historia e Tyne, Sfida e Tyne dhe Jetët Punëtore kanë ndenjëse me krahë dhe stola. Në Telat e Gjallë ka ndenjëse me krahë dhe një divan. Në Labirintin e Shkencës në katin e dytë ka stol dhe një zonë pushimi me divanë në Veprat e Modës.

Marrja hua e një karrigeje me rrota

Ofrohen dy karrige me rrota për përdorim nga vizitorët. Ato mund të gjenden në hyrjen kryesore. Ju lutemi pyetni tek Sporteli i Informacionit.

Telefoni publik

Telefoni në dyqan mund të përdoret pas një kërkesë emergjence ose për të prenotuar taksit për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Planet e galerive

Në Sportelin e Informacionit ofrohen plane standarde, me shkronja të mëdha dhe me alfabet Braille.

Informacion para vizitës

Paketat para vizitës ofrohen falas për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar që të planifikojnë vizitën. Lutemi kontaktoni me muzeun. Paketat përfshijnë:

- Fletëpalosje të muzeut me shkronja të mëdha
- Fletëpalosje të muzeut në alfabet Braille
- Guidë e detajuar me shkronja të mëdha e muzeut dhe ambienteve të tij
- Guidë e detajuar në alfabet Braille e muzeut dhe ambienteve të tij
- Guidë e detajuar audio në CD e muzeut dhe ambienteve të tij
- Guidë e detajuar audio në kasetë e muzeut dhe ambienteve të tij
- Harta me shkronja të mëdha të kateve të Muzeut
- Harta në alfabet Braille dhe me prekje të kateve të Muzeut

Qentë

Ne i mirëpresim qentë ndihmës. Sporteli i Informacionit mund të sigurojë një tas me ujë.

Qarqet e induktuara

Në Historinë e Tyne, Sfida e Tyneside dhe Jetët Punëtore ka të instaluar pika induksioni. Edhe në Hollin e Madh ka të instaluar një qark induksioni. Qarqet e vegjël janë instaluar në dyqan, në Sportelin e Informacionit dhe në receptionin dhe barin e Muzeve Tyne & Wear.

Ekranet

Shumica e pikave audio kanë poshtë tyre edhe versionin me tekst. Ekranet audio vizualë në Historia e Tyne, Sfida e Tyneside dhe Jetët Punëtore kanë titra. Në ekranin video të Inovatorëve Verilindorë jashtë Sfidës së Tyneside është shtuar interpretimi në Gjuhën Britanike të Shenjave.

Guidat audio

Një guidë audio e përgjithshme e pjesëve me interes disponohet në anglisht, në urdu, në silheti, në kantonisht, në frëngjisht dhe në norvegjisht. Një guidë përshkruese audio për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar përfshin gjithashtu një sërë përvojash me prekje.

Receptori audio është i ngjashëm me telekomandën e televizorit. Ai ka butona që shtypen me numra, dhe play e pause. Ka kufje opsionale dhe rripa për funksionim pa duar. Guida është falas për të verbrit dhe njerëzit me shikim të kufizuar dhe ofrohet në Sportelin e Informacionit në katin nëntokë.

Vizita me guidë në Muze

Kuratori, shërbimet për vizitorët dhe stafi i mësimit mund të kryejnë guidë, por kjo duhet të prenotohet më përpara. Ato zgjasin midis dyzet e pesë minutave deri në një orë.

Alarmet e zjarrit

Alarmet e zjarrit kanë tinguj zëri për evakuim, drita pulsuese vizuale dhe përreth muzeut ka mesazhe me tekst që rrotullohen. Ashensori nuk mund të përdoret në rast zjarri. Ka karrige

evakuimi për të ndihmuar njerëzit që nuk dalin dot nga ndërtesa dhe pika për strehim të sigurt nga zjarri pas evakuimit. Këto sinjalizohen qartë me tabela. Nëse ju duhet ndihmë për të dalë nga ndërtesa në rast zjarri, lutemi lajmëroni një anëtar të stafit.

Tualetet dhe ndërrimi i bebeve

Në katin përdhe dhe në katin e dyte ka tualete meshkujsh dhe femrash. Tualete të aksesueshëm të ndarë gjenden në katin përdhe, në të parin dhe në të dytin. Tualeti i aksesueshëm në katin e dytë ka edhe një shtrat dhe dush me ndenjësë. Në Galerinë e Njerëzve në katin përdhe ka edhe një tualet të aksesueshëm të gjerë të pajisur me çikrik, shtrat dhe dush.

Ka vend për të ndërruar bebet në tualetet e femrave dhe të meshkujve në katin përdhe dhe në katin e dytë dhe në tualetet e aksesueshëm në katin përdhe, në katin e parë dhe në katin e dytë si edhe në tualetin e aksesueshëm të gjerë të Galerisë së njerëzve.

Ushqimi në Café Discovery

Bari gjendet në katin e dytë. Ofrohen pije të ftohta dhe të nxehta dhe ushqim e sanduiçë gjatë orarit të drekës. Sipas kërkesës, ofrohen menu me shkronja të mëdha, takëme ngrënieje me doreza të mëdha dhe filxhanë me bisht të hapur.

Nëse mund të bëjmë gjë për ta bërë vizitën tuaj më të këndshme, lutemi na kontaktoni, do t'ju ndihmojmë me kënaqësi.

Aftësitë e Kufizuara dhe Aksesit

Kjo guidë është krijuar për të ndihmuar dhe për t'u mundësuar vizitorëve tanë me aftësi të kufizuara të shijojnë plotësisht vizitën e tyre në Muzeun e Hertford-it.

Muzeu i Hertfordit i mirëpret vizitorët me aftësi të kufizuara, së bashku me ndihmësit apo kujdestarët e tyre, dhe ne kërkohet në mënyrë aktive të promovojmë dhe të sigurojmë mundësi të barabarta për të gjithë vizitorët. Dëshirojmë t'i nxitim të gjithë që të shijojnë plotësisht gamën e ambienteve dhe të argëtimit që disponojmë.

Planifikimi i vizitës tuaj

Muzeu është i hapur nga e marta deri të shtunën nga ora 10 paradite deri në orën 5 pasdite, dhe hyrja është falas. Zakonisht ka një tarifë të vogël për aktivitete apo seminare të veçanta. Muzeu gjendet në Bull Plain, sapo del nga Maidenhead Street në qendër të qytetit. Rruga mund të bëhet me makinë. Jashtë muzeut ka vija të verdha të dyfishta.

Parking ofrohet në Bull Plain (i kufizuar deri në 30 min) dhe në parkingun me shumë kate në Gascoyne Way ose Bircherley Green dhe në St Andrew Street (qëndrim i shkurtër) të cilat janë pranë në qytet. Në skajin tjetër të Bull Plain ka 3 vende për njerëzit që kanë shenjën e aftësve të kufizuara.

Për më shumë informacion rreth shërbimeve të Muzeut Hertford, lutemi kontaktoni me muzeun në 01992 582686 dhe kërkoni të flisni me Kuratoren, Helen Gurney. Përndryshe, dërgoni një email në muze në info@hertfordmuseum.org.

Aksesi në shërbimet e Muzeut

Muzeu Hertford gjendet në një ndërtesë të klasifikuar si Grada II e cila daton që nga viti 1610. Ajo është bërë muze në vitin 1914 dhe tashmë ky muze është një shoqatë bamirëse dhe muze i regjistruar që merr mbështetje nga Këshilli i Qytetit të Hertford-it. Ai mbështetet shumë në mbështetjen dhe donacionet publike.

Muzeu u hap përsëri për publikun në shkurt të vitit 2010 pas një projekti të madh zhvillimi të financuar nga Lotaria e Trashëgimisë i cili përfshinte përmirësimin e shërbimeve të muzeut në mënyrë që komuniteti lokal dhe vizitorë të tjerë të kenë akses dhe të shijojnë trashëgiminë e tyre.

Hyrja

Hyrja gjendet në një kat dhe dera e përparme rri gjithmonë hapur gjatë orëve kur është hapur Muzeu. Kur ai është mbyllur (të hënën dhe të dielën), ka zile që lajmëron anëtarët e stafit për dorëzimet.

Holli ka dyer automatike që hapen për t'u dhënë vizitorëve akses në ndërtesë.

Kati përdhe

Pasi hyni nga dyert automatike, ka një pupitër me një hartë orientimi të ngritur mbi të që u tregon vizitorëve planin e ndërtesës.

Në të majtë të hyrjes gjendet dhoma e burimeve, tre kompjuterë për përdorim nga vizitorët (me akses në internet dhe mundësi për printim) dhe një derë që çon në dhomat e ekspozitave. Ka gjithashtu edhe një kioskë me ekran me prekje ku vizitorët mund të aksesojnë koleksionin fotografik.

Në të djathtë të hyrjes gjendet kompjuterët për vizitorët, dhe zona e receptionit (me një sportel me lartësi të aksesueshme nga karriget me rrota) dhe dyqani i muzeut. Sporteli i receptionit ka të instaluar një qark dëgjimi.

Disa prej objekteve në dyqanin e muzeut janë në rafte të lartë, por në reception ka gjithmonë staf i cili është më se i lumtur të ndihmojë njerëzit.

Ka një platformë të pjerrët me parmak e cila çon nga dyqani i muzeut dhe sporteli i receptionit për në ekspozimet e muzeut. Dyshemeja këtu ndryshon nga qylym në parket prej druri. Dhoma është e lyer në të kuqe të errët dhe ka 5 madhësi të ndryshme të vitrinave ekspozuese me objekte të ndryshëm si dhe objekte të varura në mur.

Drejt përpara gjendet platforma e ashensorit e cila çon në katin tjetër (tek tualetet, Dhoma Andrews si dhe jashtë në kopsht). Stafi do t'i ndihmojë njerëzit të përdorin këtë ashensor. Në anën tjetër të dhomës gjendet platforma e ashensorit që çon në ekspozimet e katit të parë. Stafi do t'i ndihmojë njerëzit të përdorin këtë ashensor.

Drejt përpara janë tre shkallë që çojnë në katin tjetër.

Tualetet dhe Dhoma Andrews

Në katin tjetër ka një holl të vogël (të shtruar me qylym). Muret janë në ngjyrë më të çelët.

Në të djathtë gjendet një WC e aksesueshme nga karriget me rrota e cila është gjithashtu e pajisur me tualet të përshtshëm për fëmijë të vegjël si dhe një ambient për ndërrimin e pelenave. Në këtë dhomë ka një kordon i cili mund të tërhiqet në rast emergjence për të lajmëruar stafin në reception. Kjo dhomë ka dysheme me pllaka dhe mure të lyer në ngjyrë të çelët.

Drejt përpara gjendet Dhoma shumë-funksionale Andrews e cila përdoret për aktivitete, vizita shkollore dhe grupe. Ajo nuk është gjithmonë e hapur. Mund të kërkoni paraprakisht në faqen e internetit ose të pyesni stafin tek receptioni për çfarë po ndodh në muze. Kjo dhomë ka një dysheme me linoleum dhe është e lyer me ngjyra të ndezura e ka dritare të larta. Dhoma hapet në kopshtin e muzeut. Ka dollapë në të dyja anët e dhomës dhe në të vendosen shpesh tavolina dhe karrige. Dy dyer me doreza që shtyhen çojnë në kopshtin e muzeut.

Në të majtë gjendet një korridor i shkurtër me një tualet për shëtitësit me aftësi të kufizuara si dhe një tualet tjetër ngjitur me të. Ata janë për bashkë për meshkuj dhe femra. Të dy kanë dysheme me pllaka me mure me pllaka ngjyrë blu.

Pranë tyre gjendet një derë me dorezë që shtyhet e cila nxjerr në kopshtin e muzeut.

Kopshti i muzeut

Kopshti i muzeut mund të aksesohet nga kjo zonë. Ka një rrugicë të shtruar me guralecë përreth një plani qëndror me nyje dhe shtrate të tjerë lulesh përreth. Ka një 'stol kamomili' ku mund të ulen vizitorët. Në skajin tjetër gjenden tri shkallë të gjerë që vizitorët të shkojnë në katin e poshtëm. Ofrohet gjithashtu edhe një platformë e pjerrët për karrige me rrota të cilën stafi e siguron për të mundësuar akses të karriges me rrota në katin e poshtëm.

Kati i poshtëm ka një derë të madhe zjarrri dhe shtrate të tjera lulesh si edhe një zonë të vogël për t'u ulur. Kjo çon drejt (me një rrugicë të shtruar me guralecë) pjesës së pasme të muzeut ku vizitorët mund të kthehen në muze dhe ose t'u ngjiten shkallëve për në katin e parë ose të kthehen në ekspozimet e katit përdhe.

Kati i parë

Në katin e parë mund të shkohet qoftë me anë të platformës së ashensorit në zonën e ekspozimeve të katit përdhe, qoftë duke u ngjitur me shkallë.

Në zonën e ekspozimeve të katit përdhe ka një derë e cila çon në holl ku dy palë shkallë çojnë sipër në një holl me shumë hapësirë, me panele xhami, i cili u lejon vizitorëve të shohin ekspozimet përmes tyre.

Në të dy anët e shkallëve ka dyer që të çojnë tek ekspozimet.

Ekspozimet e katit të parë janë vetëm një dhomë e hapur. E gjithë dhoma është e shtruar me tapet dhe është e niveluar. Ka shumëllojshmëri madhësisht të ndryshme të vitrinave ekspozuese me shumë objekte brenda tyre. Në çdo vitrinë ka panele teksti me etiketa. Gjithashtu, ka tabela mbi shumicën e vitrinave ekspozuese që u tregojnë vizitorëve se çfarë përmbajnë. Shumica e objekteve gjenden në vitrina. Disa prej tyre janë të varur në mur. Në ekspozim të hapur gjendet një karrige dentisti.

Ka objekte që mund të preken në disa ose afërsisht në disa prej vitrinave ekspozuese.

Ka ekspozita interaktive si zoetropë që rrotullohen, kuti veshjeje për fëmijët, një bankë shkolle e vjetër, një zonë ku mund të luhet dyqanesh dhe interaktivi magnetik 'i shpërnguluri i kohës së luftës'.

Ka 4 'vende dëgjimi' përreth ekspozimeve të cilat kanë regjistrime që lidhen me tema të ndryshme si për shembull, ditët e shkollës, punës, koha e lirë. Transkriptet e tyre të shtypur

ofrohen në recepsion ose në parvazët e dritareve pranë karriges së dentistit.

Pranë hyrjes së ashensorit, ka një ekspozim rrethor të montuar në tavan me fytyra shumë të njohura të Hertford-it të cilave u janë vendosur numra. Vizitorët mund të përdorin telefonin e zi të modelit të vjetër dhe të formojnë njërin nga numrat për të marrë më shumë informacion rreth çdo fytyre të Hertford-it. Pranë tij gjendet informacion i shtypur për çdo fytyrë.

Secila derë e kësaj dhome i nxjerr vizitorët në katin e poshtëm. Kthimi në katin përdhe ofrohet gjithashtu edhe me anë të platformës së ashensorit pranë rrethit të fytyrave të Hertford-it.

Ambiente të aksesueshme



Tualetet

Ka **tualete të aksesueshme** në galerinë e Gjitarëve, dhe në barin e katit nën tokë. Në Zonën e Kuqe, ata janë në korridorin e hyrjes. Në Qendrën Darwin, do tëi gjeni pranë sportelit të informacionit.

Ushqimi dhe pazari

Shumica e banakëve në **restorantët dhe baret** tanë janë të aksesueshëm. Stafi me njohuri mbi aftësitë e kufizuara është i gatshëm të ndihmojë. Merrni më shumë informacion mbi ushqimin dhe pijet e dyqanet.

Gjuha e shenjave

Disa prej anëtarëve të stafit të muzeut ofrojnë aftësi për **komunikim në gjuhën e shenjave**. Interpretimi në gjuhën e shenjave është pjesë përbërëse e programit edukativ të Muzeut, për më shumë informacion lutemi telefononi në linjën e prenotimit të shkollave në +44(0)20 7942 5555.

Ne organizojmë gjithashtu **Biseda Live mbi Natyrën** dhe **Vizita të Koleksionit të Gjallesave të Ruajtura në Formalinë** të cilat interpretohen në gjuhën e shenjave. Këto biseda dhe vizita falas do t'ju japin hollësi entuziazmuese mbi Muzeun tonë dhe koleksioneve në prapaskenë. Kontrolloni oraret dhe datat. Për më shumë informacion, na dërgoni email.

Telefonat

Ka **telefonë të aksesueshëm** në korridorin e hyrjes së Rrugës Cromwell, në korridorin e hyrjes së Sallës Qendrore dhe në korridorin e hyrjes tek Galeritë e Tokës.

Typetalk

Ne i mirëpresim thirrjet me telefon që kthen zërin në tekst me anë të Typetalk, me prefiks përdoruesi 18001 020 942 5000.

Biblioteka dhe dhomat e leximit

Imazhet online mund të shihen në Bibliotekë në **ekranë me rezolucion të lartë**. Disponohen një sërë dhomash leximi të aksesueshme. Lutemi kërkojini ndihmë stafit. Mund të aksesoni Katalogun e Bibliotekës duke përdorur softuerët Jaws ose Zoomtext, që janë instaluar në një kompjuter të Bibliotekës së Përgjithshme.

Orari i hapjes së bibliotekës: Nga e hëna në të premte, 10:00 deri në 16:30. Për më shumë informacion, lutemi telefononi në sportelin e informacionit të Bibliotekës në +44 (0)20 7942 5460.

Vizita të Koleksionit të Gjallesave të Ruajtura në Formalinë në Qendrën Darwin

Nëse keni kërkesa për akses, është shumë e rëndësishme që të prenotoni paraprakisht vizitën. Lutemi telefononi në +44 (0)207 942 6128 ose prenotoni vetë në njërin prej sporteleve të informacionit duke shpjeguar kërkesat tuaja për akses.

<http://www.nhm.ac.uk/print-version/?p=/visit-us/access-guide/accessible-facilities/index.html>Page 1 of 1



Studimi dhe ruajtja

| Qendra e biznesit

| Rreth nesh


| Kërkoni

Hyni | [Rëgjistrohuni](#) | [Pse të regjistroheni?](#)
[Kryefa](#) | [Na vizitoni](#) | [Natyra online](#) | [Natyra Plus](#) | [Vetëm për fëmijët](#) | [Edukim](#) | [Na mbështetni](#) | [Blini online](#) | [Tring](#)
Ju jeni këtu: [Kryefaja](#) > [Na vizitoni](#) > [Guidë aksesi](#) > [Hyrjet e muzeut](#)

Hyrjet e muzeut

Guidë aksesi

- [Udhëtim i aksesueshëm](#)
- [Hyrjet e muzeut](#)
- [Lëvizja përreth muzeut](#)
- [Ambiente të aksesueshme](#)



Zgjidhni cila hyrje e muzeut ju përshtatet.

Muzeu ka 2 hyrje, Rruga Cromwell ka **shkallë**. Ekspozita Rruga e hyrjes nuk ka shkallë dhe është shumë e mirë për karrige me rrota dhe karrige që shtyhen.

hyrjen e Rrugës Cromwell,
10 shkallë me një rrugicë me platformë në të dyja anët e hyrjes

Rruga e hyrjes për në ekspozitë
Nuk ka shkallë në korridorin e hyrjes. Më tej gjenden 18 shkallë, ose mund të merrni ashensorin.

Karriget me rrota mund të jepen hua në garderojë në hyrje të Ekspozitës në Rrugën e hyrjes.

Akses pa shkallë pas orarit zyrtar

Mund të prenotohet parkim i kufizuar me anë të Dhomës së Kontrollit për mbajtësit e Simbolit Blu në +44 (0)20 7942 5888.

Nëse keni nevojë për ndihmë apo keni pyetje në lidhje me këto masa atëherë lutemi kontaktoni me Shërbimin ndaj Klientit me telefon në +44 (0)20 7942 5839 ose [na dërgoni email](#).

[Version për printim](#)

Planet e kateve



- Zona Blu
- Zona e Kuqe
- Zona e Gjebër
- Zona Portokalli

Shënim

Shënoje këtë faqe në [Natyra Plus](#)
Shihni shënimet e njerëzve të tjerë

Informacioni përkatës

- Si të vish këtu
- Galeritë
- Guida e mbijetesës së prindërve
- Kontakt dhe pyetje

Lidhje të jashtme

- Muzeu dhe South Kensington në Harta e Google
- Transport për Udhëtim në Londër Planifikuesi

Kutia e instrumenteve

- Version për printim
- Dërgoje këtë faqe me email

Ndajeni këtë



[Pëlqej](#) 5

[Tweet](#) 1


[Studimi dhe ruajtja](#)
[Qendra e biznesit](#)
[Rreth nesh](#)
[Kërkoni](#)

[Hyni](#)
[Rëgjistrohuni](#)
[Pse të regjistroheni?](#)
[Kryefaqja](#)
[Na vizitoni](#)
[Natyra online](#)
[Natyra Plus](#)
[Vetëm për fëmijët](#)
[Edukim](#)
[Na mbështetni](#)
[Blini online](#)
[Tring](#)


Ju jeni këtu: [Kryefaqja](#) > [Na vizitoni](#) > [Guidë aksesi](#) > Lëvizja përreth Muzeut

Lëvizja përreth muzeut

Guidë aksesi

[Udhëtim i aksesueshëm](#)

[Hyrjet e muzeut](#)

[Lëvizja përreth muzeut](#)

[Ambientet e aksesueshme](#)



Ashensorët

Të gjitha katet në zonat Blu, të Gjelbra dhe të Kuqe dhe Qendra Darwin aksesohen me ashensor. Aktualisht, nuk ka akses pa shkallë për në Laboratorin e Tokës, por mund të gjeni informacion të zgjeruar mbi identifikimin e gurëve, mineraleve dhe fosileve në [Sitiin e të dhënave të Laboratorit të Tokës](#).

Qentë guidë

Ne i mirëpresim qentë guidë. Ka zona me bar për ta jashtë, dhe ofrohet ujë sipas kërkesës. Garderoba ofron një vend të sigurt për ta **lënë qenin tuaj me kujdestarë**. Për më shumë informacion, lutemi telefononi në sportelin e informacionit në +44 (0)207 942 5011.

Hartat

Lutemi kërkoni **hartë me shkronja të mëdha të Muzeut**, në çdo sportel informacioni. **Vizitorët me aftësi të kufizuara**

Ne kemi një politikë pranimi gjithëpërfshirëse e cila siguron që gjithë vizitorët që paguajnë të trajtohen njëjloj dhe me dinjitet. Vizitorët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e një bilete koncensionare për ekspozitat tona me pagesë. Ata kanë gjithashtu të drejtë të shoqërohen nga deri në 2 ndihmës pa pagesë.

*Biletat koncensionare u ofrohen gjithashtu fëmijëve, të rriturve mbi 60 vjeç, studentëve dhe të papunëve (mund të kërkohet vërtetim).

Karriget me rrota

Karriget me rrota **mund të jepen hua** në garderobë. Ato mund të gjenden në hyrje të Rrugës së Ekspozitës dhe prapa Sallës Qendrore në krah të tualeteve kryesore. Ky shërbim ofrohet pa pagesë.

Evakuimet në rast emergjence

Nëse keni nevoja të veçanta në rast të një **evakuimi emergjence**, lutemi na vini në dijeni kur të mbërrini. Përgjatë gjithë Muzeut ka **zona të sigurta strehimi** të lidhura me dhomën e kontrollit me anë të interkomit.

Shënime

Shënojeni këtë faqe në Natyra Plus
Shihni shënimet e njerëzve të tjerë

Informacioni përkatës

Galeritë

Siti i të dhënave të laboratorit të Tokës

Kutia e instrumenteve

Version për printim

Dërgoje këtë faqe me email



Në vitin 2003, afërsisht 12 000 shkencëtarë nga mbi 60 shtete erdhën të punonin në Muze.



Më shumë informacion

Version për printim

[Kontakt dhe pyetje](#) | [Aksesueshmëria](#) | [Harta e faqes](#) | [Kushtet e përdorimit](#) | [Informacion mbi cookies](#) | [Celular](#)

© 2013 Muzeu i Historisë së Natyrës. Të gjitha të drejtat të rezervuara